

UNIVERSITETI I GJILANIT “KADRI ZEKA”
FAKULTETI I EDUKIMIT
STUDIME POSTDIPLOMATIKE – MASTER
DREJTIMI- MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA NË ARSIMIN FILLORË



PUNIM DIPLOME
ROLI I BASHKËPUNIMIT PRIND-MËSUESE NË REALIZIMIN E AKTIVITETEVE
MËSIMORE NË SHKOLLË FILLORE

Mentori:
Kandidatja:

Prof. Asoc. Dr. Mensur Neziri
Albaneta Bega Demelezi

Gjiçan, 2024

UNIVERSITETI I GJILANIT “KADRI ZEKA”
FAKULTETI I EDUKIMIT
STUDIME POSTDIPLOMATIKE – MASTER
DREJTIMI- MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA NË ARSIMIN FILLORE



PUNIM DIPLOME

ROLI I BASHKËPUNIMIT PRIND-MËSUESE NË REALIZIMIN E AKTIVITETEVE
MËSIMORE NË SHKOLLË FILLORE

Mentori:

Kandidatja:

Prof. Asoc. Dr. Mensur Neziri

Albaneta Bega Demelezi

Gjilan, 2024

© [2024]-[Albaneta Bega Demelezi] Të gjitha të drejtat të rezervuara.

FALËNDERIME

Ndjejë se universiteti dhe sidomos studimet master më kanë përgatitur më shumë për gjithçka që vjen më pas. Kështu që dua të ndaj falënderimet e mia për të gjithë ata që kanë qenë pjesë e këtij viti të studimeve.

Faleminderit Fakultetit të Edukimit që më përqafoi krahëhapur, mbështeti qëllimet e mia dhe u bë shtëpia ime e dijes.

Faleminderit kolegëve që më treguan se nuk jam vetëm në mendimin tim, humbjet, luftimet dhe fitoret.

Ky hulumtim nuk do të ishte i mundur pa ndihmën dhe përkrahjen e institucioneve arsimore ndaj një falënderim i veçantë i dedikohet drejtorëve dhe mësuesëve që bënë të mundur realizimin e këtij studimi. Dërguat përvojen time në një tjetër nivel zgjeruat perspektivën time.

Së fundi për familjen time ; kurrë nuk do të mundem të ju falenderoj mjaftueshëm për dashurinë dhe mbështetjen tuaj ndaj meje. Faleminderit që më dhatë mundësinë të bëjë diçka nga vetja dhe që më dhatë lirinë për të bërë rrugen time ashtu siç unë doja.

ABSTRAKTI

Përmes këtij hulumtimi do të mundohemi të vëmë në pahë rolin e bashkëpunimit prind-mësuese në realizimin e aktiviteteve mësimore. Në këtë kontekst, bashkëpunimi i mësueseve me prindërit në realizimin e aktiviteteve mësimore, paraqitet si çështje me rëndësi për cilësinë dhe për ndikimin e edukimit në shkollat fillore. Ky hulumtim është realizuar me qëllim që të analizohet roli i bashkëpunimit në mes mësueseve dhe prindërve në organizimin e aktiviteteve mësimore në institucionet arsimore të Kosovës.

Metodologjia e hulumtimit është mikes cilësore-sasiore, e cila përmes instrumenteve siguron pamje të qarta të rolit të bashkëpunimit mësuese-prind në institucione arsimore në vendin tonë.

Hulumtimi do të realizohet në qytetin e Ferizajit dhe të Gjilanit ku pjesmarrësit do të jenë të gjitha mësueset nga klasa I-V në shkollën fillore “Vezir Jashari” dhe “Gjon Serreqi” në Ferizaj dhe në shkollën fillore “Selami Hallaqi” dhe “Musa Zajmi” në Gjilan, po ashtu dhe prindër të cilët fëmijët e tyre vijnë në ato institucione arsimore.

Për mbledhjen e të dhënave do të përdoret pyetësi të cilat do të mbulojnë pyetjet e hulumtimit duke filluar nga rëndësia e rolit të bashkëpunimit mësuese-prindër deri tek format më specifike të bashkëpunimit në mënyrë që të arrihen synime të veçanta përmes bashkëpunimit.

Analiza e të dhënave do të bëhet në bazë të transkriptimit dhe kodimit të të dhënave. Të dhëna këto të cilat do t'i japin një kahje ndërgjegjesimi të angazhuarve profesionalë në arsimin fillore mbi rolin e bashkëpunimit prind-mësuese në aktivitete mësimore.

Fjalet kyçe: *Aktivitete mesimore, bashkëpunim, mësuesle , prind, institucion arsimor .*

ABSTRACT

Through this research we will try to highlight the role of parent-teacher cooperation in the realization of teaching activities. In this context, the cooperation of teachers with parents in the realization of teaching activities is presented as a matter of importance for quality and for the impact of education in primary schools. This research was conducted in order

to analyze the role of cooperation between teachers and parents in organizing learning activities in educational institutions.

The research methodology is a qualitative-quantitative friend, which through the instruments provides clear view of the role of teacher-parent cooperation in educational institutions in our country.

The research will be conducted in the city of Ferizaj and Gjilan where participants will be N = 100 parents who attend school in those educational institutions and N =100 teachers working in educational institutions.

For the collection of data, the questionnaire will be used which will cover research questions ranging from the importance of the role of teacher-parent cooperation to more specific forms of cooperation in order to achieve specific goals through collaboration.

Data analysis will be done based on the transcription and coding of the data. Data that will give an awareness-raising approach to the professional engaged in primary education on the role of parent-teacher cooperation in learning activities.

The main words: Teaching activities, collaboration, teacher, parents, educational institutions.

Tabela e përmbajtjes

[FALËNDERIME](#)

[ABSTRAKTI](#)

[ABSTRACT](#)

[Tabela e grafikëve](#)

[1. HYRJE](#)

[2. SHQYRTIMI I LITERATURËS](#)

[2.1. Modelet teorike për përfshirjen e prindërve](#)

[2.1.1. Modeli ekologjik i zhvillimit të fëmijës Bronfenbrenner](#)

[2.1.2. Programet e përfshirjes së prindërve sipas Epstein](#)

[2.1.3. Modeli për përfshirjen e prindërve sipas Hornby](#)

[2.1.4. Kontributet prindërore](#)

[2.1.5. Modeli i përfshirjes së prindërve sipas Hoover- Dempsey & Sandler](#)

[2.1.6. Legjislatura vendore që mbështet bashkëpunimin mësuese/e-prind](#)

[2.1.7. Metodologjitë që mbështesin rolin e bashkëpunimit mesues/e-prind gjatë realizimit të aktiviteteve mesimore](#)

[2.1.8. Roli i bashkëpunimit te familjes në aktivitete mesimore sipas metodologjisë “Montessori”](#)

[2.1.9. Roli i bashkëpunimit te familjes në aktivitete mesimore sipas metodologjisë “Rexhio Emilia”](#)

[2.1.10. Roli i bashkëpunimit te familjes në aktivitete mesimore sipas metodologjisë “Hap pas Hapi”](#)

[2.1.11. Strategjitë për një bashkëpunim më të mirë](#)

[Sipas Federatës Amerikane të mësimdhënësve \(2007\) për një bashkëpunim efektiv duhet të përdorim disa strategji siç janë:](#)

[2.2. Komunikimi si hap fillestar për bashkëpunimin mesues/e-prind](#)

[2.2.1. Komunikimi me fëmijët dhe prindërit](#)

[2.2.2. Ndikimi i komunikimit efektiv në marrëdhëniet mesues/e-prind](#)

[2.3. Bashkëpunimi mesuese/e -prind në aktivitete edukative](#)

[2.3.1. Kur ndodh përfshirja e prindërve dhe angazhimi familjar?](#)

[2.3.2. Motivimi i prindërve për të bashkëpunuar në shkollën fillore](#)

[2.3.3. Praktikrat pozitive të përqendrimit dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë](#)

[2.3.4. Si të mësoj për ecurinë e fëmijës sim në institucion arsimor?](#)

[2.3.5. Si mund të marrin pjesë prindërit në aktivitetet mesimore të institucionit arsimor?](#)

[2.3.6. Roli i prindërve gjatë bashkëpunimit me mesuesen apo mesuesin në realizimin e aktiviteteve edukative](#)

[2.3.7. Pjesëmarrja e prindërve në aktivitete praktike](#)

[2.3.8. Aktivitetet mesimore në shtëpi të mbështetura nga prindërit](#)

[2.3.9. Avantazhet e përfshirjes së prindërve në institucione arsimore](#)

[2.3.10. Disavantazhet e përfshirjes së prindërve në institucione arsimore](#)

[2.3.11. Sugjerime për të ndihmuar familjet të kuptojnë vlerën e mësimi dhe të përfshihen në realizimin e aktiviteteve mesimore](#)

[2.4. Shpjegimi i nocioneve bazë](#)

[2.4.1. Nocioni bashkëpunim](#)

[2.4.2. Nocioni familje](#)

[2.4.3. Nocioni institucion arsimor](#)

[2.4.4. Nocioni mesues/e](#)

[2.4.5. Nocioni aktivitete mesimore](#)

[3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT](#)

[3.1. Objektivat](#)

[3.2. Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat](#)

[3.3. Parashtrimi i problemit](#)

[3.4. Rëndësia e hulumtimit](#)

[3.5. Qëllimi i hulumtimit](#)

[3.6. Popullacioni dhe mostra](#)

[3.7. Instrumentet matëse](#)

[3.8. Etika e hulumtimit](#)

[4. REZULTATET E HULUMTIMIT](#)

[4.1. Mënyra e mbledhjes së të dhënave](#)

[4.2. Prezantimi i gjetjeve kryesore](#)

[5. DISKUTIME](#)

[5.1. Diskutimi mbi shpërndarjen demografike të respondentëve-prindërve](#)

[5.2. Diskutimi mbi rolin dhe format e bashkëpunimit mësues/e-prind në realizimin e aktiviteteve mësimore](#)

[6. Përfundime dhe rekomandime](#)

[6.1. Përfundime të përgjithshme](#)

[6.2. Rekomandime](#)

[Referencat](#)

[Shtojcë](#)

Tabela e grafikëve

[Grafiku 1. Përqindja e numrit të mësueseve dhe prindërve në hulumtim sipas dy komunave](#)

Grafiku 2. Institucioni arsimor ku vijon fëmija mësimin, ofron mundësi që të marrë pjesë në realizimin e aktiviteteve mësimore

Grafiku 3. Është përgjegjësi e prindit që të marrë pjesë në realizimin e aktiviteteve mësimore që zhvillohen në institucion arsimor ku fëmija ndjek mësimin

Grafiku 4. Rregullisht njoftohemi për aktivitetet mësimore që zhvillohen në institucion arsimor

Grafiku 5. Ndajmë njohuritë dhe idetë e tona gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore që zhvillohen në institucion arsimor

Grafiku 6. Prindërit janë të përfshirë në çdo mbledhje që organizon institucioni me interes për fëmijët e tyre

Grafiku 7. Kontaktojmë vazhdimisht me institucion arsimor në mënyrë që të ndihmohet fëmija në shtëpi

Grafiku 8. Mësuesja njofton për fushat kurrikulare ku fëmija ka nevojë për mbështetje

Grafiku 9. Ne njoftohemi për aftësitë, nevojat, specifikat e tjera që mund të ndikojnë në procesin e edukimit dhe ta pajisë me udhëzime për formën e mbështetjes

Grafiku 10. Institucioni arsimor ofron hapësira ku mund të flasim për shqetësimet, nevojat, problemet dhe dëshirat lidhur me fëmijën.

Grafiku 11. Metodrat që ju i përdorni i shihni efektive në përfshirjen e prindërve

Grafiku 12. Format e komunikimit që ju i përdorni për të komunikuar, ndikojnë tek realizimi i aktiviteteve mësimore

Grafiku 13. Fëmijët angazhohen me aktivitete mësimore në shtëpi dhe prindërit i përgjigjen këtij angazhimi

1.

HYRJE

Funksioni i një bashkëpunimi të mirë mësuese-prind është më shumë se thjesht një udhëzim për raportet e mësueses për prindin, se si sillet dhe vepron fëmija i tij në institucion arsimor. Bashkëpunim mundëson rrjedhjen e informatave në të dyja anët nga mësuesja tek prindërit për arritjet e fëmijës në institucion si dhe nga prindi tek mësuesja për realizimin e aktiviteteve mësimore në shtëpi. Bashkëpunimi mësues/e-prind siguron një mekanizëm që mësueset ta ftojnë dhe ta mbështesin pjesëmarrjen aktive të prindërve në aktivitete mësimore dhe në ambientin shtëpiak të tyre. Sepse në përgjithësi, prindërit e kanë njohurinë bazike më të mirë për fëmijën. Është për interesin më të mirë të nxënësve që të përfitojnë përparësi të plotë nga ai informacion si një ndihmë në kuptimin dhe vlerësimin e një nxënësi. Duke e ditur mësueset se si një fëmijë sillet në shtëpi dhe në

kontekste të tjera si sillet jashtë institucionit, pra bashkëpunimi me prindërit mund të ndihmojë mesueset që t'i balancojnë mirë vlerësimet e tyre për nxënësit. Funksionimi i këtij komponenti, gjatë realizimit të punës me nxenesit e shkollës fillore, është obligim i secilit institucion arsimor në përgjithësi, dhe i secilës mësuese në veçanti. Alternativat e rolit të bashkëpunimit me prindër, janë specifike për secilin vend, për secilën shoqëri dhe për secilën kulturë të familjes. Mësueset duhet të jenë të përgatitura që të bashkëpunojnë me prindërit me kujdestarin e nxënësit apo ndonjë i afërm i cili kujdeset për të. Po ashtu bashkëpunimi mesuese-prinder-komunitet në institucion arsimor ka një rëndësi të madhe sepse ai bashkëpunim ndikon dhe në krijimet e koncepteve të para thelbësore për jetën e nxënësve.

2.

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Në këtë kapitull, i cili përmban shqyrtimin e literaturës, materiali është ndarë në disa pjesë. Në pjesën e parë përmbledhet shpjegimi i nocioneve bazë të edukimit lidhur me temën e studimit. Pjesa e dytë shqyrtimi i literaturës paraqet aspektin teorik mbi përfshirjen dhe bashkëpunimin e prindërve në institucionet arsimore. Në pjesën e tretë përshkruhen legjislacionet vendore të cilat mbështesin bashkëpunimin e prindërve në institucionet arsimore. Pjesës së katërt i takon një përmbledhje e metodologjive që përkrahin bashkëpunimin e prindërve me institucione arsimore . Pjesa e pestë paraqet ndikimin e komunikimit të mësueseve dhe prindërve në bashkëpunim gjatë zhvillimit të aktiviteteve mësimore ne shkollat fillore. Shqyrtimi i literaturës përmbillet me pjesën e fundit ku është përshkruar mënyra se si bashkëpunojnë mësueset me prindërit gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore.

Idenë fillestare mbi rolin e bashkëpunimit mësuese-prind në botë e gjejmë qysh në kohërat e mëhershme, ishin shumë psikologë si Brofenbrenner, Epstein, Hornby etj, të cilët në veprat e tyre dhanë idenë mbi bashkëpunimin, zhvillimin e fëmijëve në kontekste të ndryshme dhe edukimin e tyre (Boeree, 2004).

Kontributi i këtyre psikologëve ndihmoi që ky bashkëpunim të shikohet si shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për çdo prind dhe mësues në shkolla.

Në fillim të shekullit XX roli i bashkëpunimit mësues-prind u karakterizua me një zhvillim të hovshëm mbi fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë i cili u bë dhe një frymëzim për të gjithë mësimdhënësit dhe prindërit.

Sipas Jean. M, Lilian. K & Anne.R, Dianne.R (2003) ky bashkëpunim u krijua për një zhvillim më të mirë të fëmijës, motivim gjatë procesit mësimorë të fëmijës krijimin e vetëbesimit dhe avancimin e tyre gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore në shkollat fillore.

Ky bashkëpunim është zhvilluar në etapa të ndryshme të historisë dhe është kuptuar ndryshe, në shoqëri të ndryshme është institucionalizuar dhe rregulluar në mënyra të veçanta gjë e cila tek trekëndëshi fëmijë-prind-mësues ka orfuar përvoja të ndryshme.

Studimet historike sigurojnë të dhëna sesi roli i bashkëpunimit prind-mësues në mënyrë të vazhdueshme është riorganizuar dhe diferencuar, bazuar në faktorë të ndryshëm si në: kontekstin social, vendodhjen gjeografike të prindërve dhe mësuesve, pasurinë apo varfërinë e tyre e shumë faktorë të tjerë (Jean.M,Lilian.K, Anne.R, Dianne.R, 2003).

Mbi zhvillimin e teorive mbi rolin e bashkëpunimit mësuese-prindë në realizimin e aktiviteteve mësimore, gradualisht ndryshoi edhe qasja ndaj tyre, gjë e cila ndikojë në avancimin gradual dhe kthimin e vëmendjes së shumë studiuesve dhe politikave arsimore drejt rolit të bashkëpunimit prind-mësues në realizimin e aktiviteteve mësimore në shkollat fillore.


Teoritë dhe puna e Maria Montesorit, Rexhio Emilia për bashkëpunimin prind-mësues, teoria e Brofenbrennerit, Epstein, Hornby e shumë kërkime të tjera shkencore ndikuan në rolin e bashkëpunimit prind-mësues në realizimin e aktiviteteve mësimore.

2.1. Modelet teorike për përfshirjen e prindërve

2.1.1. Modeli ekologjik i zhvillimit të fëmijës Bronfenbrenner

Sipas teorisë së sistemeve ekologjike të Urie Bronfenbrenner gjithçka që e rrethon fëmijën ka ndikim në zhvillimin e tij, pra zhvillimi ndodh në kontekst dhe fëmija me mjedisin ndikojnë vazhdimisht në njëri-tjetrin në një mënyrë ndërvepruese (Bronfenbrenner, 1979). Kemi disa nivele në të cilat zhvillohet fëmija: Mikrosistemi, mezosistemi, ekzosistemi dhe makrosistemi. Lidhja që këto sisteme kanë me përfshirjen e prindërve në institucion është

se prindërit dhe mësueset janë të gjithë pjesë e mikrosistemit dhe interaksionet pozitive mes tyre krijojnë një balancë për rritje të individit dhe për të nxënë. Këto interaksione janë pjesë e mezosistemit të një individi. Për shembull kur mësueset dhe prindërit, komunikojnë direkt, punojnë së bashku drejt synimeve të përbashkëta, p.sh. inkurajimi i interesit të një fëmije për të marrë pjesë në aktivitete, apo praktikimi i një instrumenti për ndonjë program festiv të institucionit arsimor etj, fëmijët mund të llogarisin në sistemet e tyre të mbështetjes dhe të ndjehen më konfident në kërkimin dhe realizimin e qëllimeve. Nga ana tjetër kur mësuesjai thotë fëmijës të realizojë ndonjë aktivitet në shtëpi të paktën të jetë i angazhuar gjysmë ore në ditë por prindërit i thonë që nuk duhet të kryejë asnjë aktivitet, atëherë krijohet një konflikt në mezosistemin e fëmijës dhe mund të shkaktojë disfunkcion në zhvillimin e tij. Pra, nëse prindi beson që bashkëpunimi i tij në institucion arsimor edukativ i ndihmon suksesit të fëmijës, do të komunikon dhe bashkëpunon me institucionin arsimor dhe në këtë mënyrë kontribon në suksesin e fëmijës të tij (Woolfolk, 2010).



Burimi: (Bronfenbrenner, 1979)

2.1.2. Programet e përfshirjes së prindërve sipas Epstein

Programet e përfshirjes së prindërve sipas Epstein (2011) ndahen në gjashtë kategori:

Prindërimi: familjet janë për të ofruar kujdes për shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve të tyre, për të krijuar një mjedis në shtëpi që inkurajon të mësuarin dhe sjelljen e mirë në mjedisin e institucionit, institucionet duhet të ofrojnë informacione për t'i ndihmuar prindërit të kuptojnë dhe të nxisin zhvillimin e fëmijëve të tyre.

Komunikimi: institucionet e arsimore duhet të jenë përgjegjës për të ofruar informacion në lidhje me ecurinë e fëmijës, mjetet e komunikimit që përdorin duhet të jenë të përshtatshme për prindërit për specifikat e tyre, ndërsa ky proces duhet të jetë dydrejtimsh.

Vullnetarizmi: prindërit mund të kontribuojnë shumë në mjedisin dhe funksionin e institucionit; institucionet mund të përfitojnë shumë nga ky proces duke ofruar orare fleksible për prindërit — vullnetarë, në mënyrë që të marrin pjesë sa më shumë prej tyre, dhe duke punuar për të përputhur talentet dhe interesat e prindërve për nevojat e fëmijëve dhe edukatorëve.

Të mësuarit në shtëpi: prindërit mund të ndihmojnë fëmijët e tyre për “detyrat” që kanë për institucionin, ose mund të përsërisin disa nga mësimet që të kuptohen më mirë nga fëmijët. Kjo mund të ndodh me udhëzimet përkatëse nga mësueset.

Vendimmarrja: institucionet mund t’i japin prindërve role të rëndësishme në institucion dhe në procesin e vendimmarrjes, kjo mundësi duhet të jetë e hapur për të gjithë prindërit dhe njerëzit e një komuniteti, jo vetëm për ata që kanë më shumë kohë dhe energji për t’u marrë me këtë angazhim.

Bashkëpunimi me komunitetin: institucionet arsimore duhet të koordinojnë punën e tyre dhe me burimet e komunitetit, të bizneseve dhe grupeve të tjera për të fuqizuar programet e tyre, praktikat në familje dhe të mësuarit dhe zhvillimit, institucionet mund të ndihmojnë prindërit për të pasur më shumë akses në shërbimet mbështetëse nga institucione të tjera, si shëndetësore, ngjarje kulturore dhe programe pas shkolle (Epstein J. L., 2011).

Prindërimi

Bashkëpunimi me komunitetin

Komunikimi

Programet e përfshirjes së prindërve sipas Epstein

Vullnetarizmi

Vendimmarrja

Të mësuarit në shtëpi

Burimi: (Epstein A. , 2015)

2.1.3. Modeli për përfshirjen e prindërve sipas Hornby

Modeli teorik sipas Hornby-it (2011) për përfshirjen e prindërve, i përshkruar më poshtë, u zhvillua duke kombinuar dhe përshtatur modelet ekzistuese mbështetur gjithashtu në modelet e punës së mëparshme të vetë autorit. Modeli fillimisht u përdor nga mësuese dhe prindër që punonin me fëmijët me nevoja të veçanta por siç thotë edhe vetë autori “Ai është i aplikueshëm për të gjithë mësueset e tjera” (Hornby, 2011, pp. 50-51).

Modeli përbëhet nga dy piramida të lidhura në bazë, njëra që përfaqëson një hierarki të nevojave të prindërve, tjetri një hierarki të forcave të forta dhe kontributeve të mundshme të prindërve. Të dy piramidat demonstrojnë vizualisht nivele të ndryshme të nevojave dhe kontributet e prindërve.

Kështu, ndërsa të gjithë prindërit kanë disa nevoja dhe disa kontribute të mundshme që mund të përdoren, një numër i vogël kanë një nevojë intensive për udhëzime, ose aftësinë për të dhënë një kontribut të gjerë.

Nevojat e prindërve

Keshillimi
Edukimi
Kontakti i rregullt
Komunikimi
Informimi
Mbeshtetja
Burimet
Lidershipi

Forcat e prindërve

Burimi: (Hornby, 2011)

2.1.4. Kontributet prindërore

Formimi i politikave

Disa prindër janë në gjendje të kontribuojnë në ekspertizën e tyre përmes anëtarësisë së prindit ose organizata profesionale duke u përfshirë në borde drejtuese të institucioneve që japin mbështetje në seminare trajnuese ku mund të flasin për eksperiencat e tyre etj.

Duke vepruar si burim

Shumë prindër kanë kohën dhe aftësinë për të vepruar si vullnetarë ndihmës të mësuesve, ose forma të tjera p.sh duke ndihmuar në klasë ose në përgatitjen e materialeve apo aktiviteteve. Të tjerët mund të kenë aftësi, njohuri, kohë për të bashkëpunuar me prindërit e tjerë e kështu me radhë. Në mënyrë që të aftësojë sa më shumë prindër që të jetë e mundur për të vepruar si një burim i rëndësishëm për institucionin, mësueset kanë nevojë për aftësi komunikuese të mira si dhe aftësi praktike menaxheriale.

Bashkëpunimi

Shumica e prindërve janë të gatshëm dhe të aftë të kontribuojnë më shumë sesa thjesht dhënia e një informacioni. Prindërit janë në gjendje të bashkëpunojnë me mësueset duke forcuar programet në klasë po ashtu edhe në shtëpi, të tilla si pjesëmarrja në aktivitete edukative në institucion etj., ndonëse jo pak prindër kanë vështirësi në këtë drejtim. Mësueset duhet të jenë të pajisur me aftësinë e bashkëpunimit me prindërit në mënyrë të përkryer, në një partneritet ku zgjedhjet e prindit duhet gjithsesi të respektohen.

Ndarja e informacionit për fëmijën

Të gjithë prindërit mund të japin informacion të vlefshëm për fëmijët e tyre sepse ata i kanë njohur ata gjatë gjithë jetës së tyre dhe kanë qenë ata që kanë marrë pjesë në të gjitha kontaktet e mëparshme me profesionistë për të vlerësuar dhe planifikuar përmbushjen e tyre dhe nevojat e tyre. Informacion në lidhje me pëlqimet e fëmijëve, pikat e forta dhe dobësitë, apo edhe të dhëna në lidhje me probleme shëndetësore janë të rëndësishme jo vetëm për të ndërtuar një bashkëpunim të nevojshëm por edhe për të qenë të suksesshëm në punën me fëmijët në institucion. Prandaj, mësueset duhet të zhvillojnë aftësi të mira për të dëgjuar dhe për të biseduar me prindërit.

2.1.5. Modeli i përfshirjes së prindërve sipas Hoover- Dempsey & Sandler

Hoover- Dempsey & Sandler (1997) zhvilluan një model të përfshirjes së prindërve i cili është i ndërtuar në 5 nivele që përshkruajnë: arsyet, faktorët, rrugët, dhe aktivitetet e përfshirjes së prindërve.

Në nivelin e parë të këtij modeli është përshkruar vendimi themelor i përfshirjes së prindërve, ndërtimi i rolit personal prindëror për përfshirje, sa efikase është përfshirja e prindërve për të ndihmuar fëmijët gjatë të nxënies, perceptimi i prindërve për ftesat për përfshirje nga ana e institucionit dhe nga ana e fëmijëve.

Niveli i dytë përshkruan faktorët e mundshëm që ndikojnë në formën e përfshirjes që prindërit zgjedhin. Këto forma përfshijnë perceptimin e përfshirjes së prindërve, të aftësive dhe njohurive të tyre. Në këtë nivel ftesat specifike për pjesëmarrje prej fëmijëve, mësueseve dhe institucionit, ndikojnë në format e përfshirjes së prindërve.

Niveli i tretë sugjeron që përfshirja e prindërve, njëherazi me angazhimin, ndikon në arritjet e fëmijëve në institucion përmes disa mekanizmave specifike. Ndër më të rëndësishmet janë modelimi i aftësive të përshtatshme të prindërve lidhur me institucionin, përforsimi i të nxënimit dhe udhëzimet (p.sh. ofrimi i mundësive ndihmëse të ndryshme gjatë të nxënimit).

Në nivelin e katërt, modeli sugjeron që aktivitetet e përfshirjes së prindërve ndikojnë arritjet e fëmijëve që përfshin përdorimin e strategjive të përshtatshme. Modeli sugjeron gjithashtu që zgjedhjet e përshtatshme midis aktiviteteve të prindërve dhe pritshmërive të institucionit për përfshirjen do të ndikojnë gjithashtu aftësitë e prindërve për të mbështetur arritjet e fëmijëve përmes përfshirjes (p.sh. nëse prindërit dhe institucioni bëjnë të njëjtat supozime rreth të nxënimit të fëmijëve, aktiviteteve të realizuara dhe sjelljeve, ata do të kenë ndikim pozitiv në të nxënimit e fëmijëve).

Niveli i pestë përqendrohet në rezultatet e fëmijëve, që ndikohen nga përfshirja e prindërve. Këto rezultate përfshijnë shkathhtësitë, njohuritë dhe ndjenjën personale për të kryer sa më mirë aktivitete në institucion, apo edhe të tjera veçori që lehtësojnë të nxënimit e fëmijëve.

Ndërtimi i rolit të prindërve

Sipas Hoover-Dempsey & Sandler, (1997) modeli sugjeron që një kontribuues kryesor në vendimet pozitive rreth përfshirjes në arsimin dhe edukimin e fëmijëve do të gjenden në ndërtimin e rolit prindëror. Çfarë besojnë prindërit që duhet të bëjnë në lidhje me arsimimin dhe përparimin arsimor të fëmijëve të tyre? Ekzaminimi i hulumtimeve psikologjike dhe edukative sugjeruan që ndërtimi i rolit të prindërve ka të ngjarë të ndikohet nga parimet e përgjithshme që udhëzojnë përcaktimin e tyre, bindjet e tyre për zhvillimin dhe rritjen e fëmijëve, besimet e tyre rreth roleve të përshtatshme që kanë gjatë zhvillimeve të aktiviteteve edukative etj. Bazuar në këtë studim arrimë në përfundim që ndërtimi i rolit prindëror është shumë i rëndësishëm për procesin e përfshirjes sepse krijon një gamë themelore të aktiviteteve që janë të rëndësishme për të dyja palët si për fëmijët ashtu edhe për prindërit. Në formë tabelore është paraqitur modeli i përfshirjes sipas Hoover-Dempsey dhe Sandler.

Tabela 1. Hoveer dhe Sandler's (1995, 1997) Modeli teorik i përfshirjes së prindërve

Niveli 5

Rezultatet e fëmijëve që ndikohen nga përfshirja e prindërve	
Aftësitë dhe njohuritë	Vetë-efikasiteti për suksesin në institucion

Niveli 4

Variablat e arritjeve dhe ndërmjetësimit	
Prindërit përdorin strategji të përshtatshme zhvillimore	Përshtatja midis veprimeve të përfshirjes së prindërve dhe pritjeve të institucionit

Niveli 3

Mekanizmat e përfshirjes së prindërve që ndikojnë në institucionin e fëmijëve		
Modelimi	Përforsimet	Udhëzimet

Niveli 2

Zgjedhja e prindërve për format e përfshirjes të ndikuara nga:		
Aftësi dhe njohuri të prindërve	Kërkesa të tjera për kohën dhe energjinë e prindërve	Ftesat specifike nga fëmija dhe institucioni

Niveli 1

Vendimet themelore të përfshirjes së prindërve ndikuar nga:			
Ndërtimi i roleve të prindërve	Ndjenja e efikasitetit të prindërve për të ndihmuar fëmijën	Ftesat e përgjithshme të institucioneve për përfshirje	Ftesat e përgjithshme të fëmijëve për përfshirje

Burimi: (Walker, Wilkins, Dallaire, Sandler, & Hoveer- Dempsey, 2005).

Këto modele teorike kanë gjetur zbatim të gjerë në vende të ndryshme, po ashtu kanë kontribuar për një bashkëpunim apo partneritet të prindërve me institucione dhe për një angazhim sa më të madh në dobi të fëmijëve.

2.1.6. Legjislatura vendore që mbështet bashkëpunimin mësuese/e-prind

Sipas Ligjit Nr. 02/ L-52 (2006) pjesëmarrja e prindërve i referohet involvimit të prindërve në aranzhimet e bëra nga institucionet arsimore për të ndihmuar dhe kontribuar prindërit në efektivitetin e vendimeve në edukimin e fëmijëve të tyre, aktivitetet të cilat mbështesin plan programin e atyre të cilat asistojnë në veprimin e institucioneve arsimore. Gjithashtu si parim ku bazohet edukimi në institucione arsimore sipas Nenit 4 të Ligjit për Edukimin dhe arsimimin Nr. 02/ L-52 (2006) është që të kenë mundësitë e barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke marrë parasysh ndryshimet në mes të fëmijëve. Kurse si detyrë themelore e institucioneve arsimore sipas Nenit 8 parashikohet:

- a) Ndihma e prindërve në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve,
- b) Përparimi i cilësisë së jetesës së fëmijëve dhe familjes,
- c) Krijimi i kushteve për zhvillimin e potencialeve individuale të fëmijëve dhe manifestimin e tyre,
- d) Krijimi i kushteve për t'i aftësuar fëmijët në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që i shtron institucioni (MASHT, 2006).

Sipas Kurrikulës Bërthamë arsimit fillor (MASHT, 2016) mbështet prindërit në ndjekjen/përcjelljen e saktë të nivelit dhe arritjeve të kompetencave të fëmijëve të tyre në periudha të caktuara kohore, në bazë të njohurive, sjelljeve, ndjenjave dhe qëndrimeve që manifestojnë në situata të ndryshme jetësore, në harmoni me rezultatet e të nxënies për fusha kurrikulare dhe kompetenca.

Po ashtu sipas MASHT (2014) personeli mbështet dhe nxitë bashkëveprimin e prindërve dhe siguron mirëkuptimin e tyre në ideimin dhe realizimin e veprimtarive edukative-arsimore. Personeli mbështet prindërit si mësueset e para të fëmijëve dhe respekton kulturën dhe prejardhjen sociale të familjes. Personeli siguron informacionin e nevojshëm dhe të vazhdueshëm në lidhje me veprimtarinë e institucionit. Duke siguruar informacionin e duhur për prindërit para se fëmijët të regjistrohen në institucion arsimor, duke i njoftuar prindërit me dokumentet e shkruara ku paraqitet puna e institucionit, në të njëjtën kohë personeli iu jep prindërve një informacion të shkruar për regjistrimin e fëmijës në institucion, po ashtu personeli iu ofron prindërve informata të nevojshme për përparimin dhe vështirësitë e ngecjeve eventuale të fëmijëve, ky informacion iu jepet prindërve nëpërmjet librit të punës, paraqitjes së punimeve të fëmijëve, vendosjes në një vend të dukshëm të programimit ditor dhe javor të punës edukative apo dhe formave të tjera (MASHT, 2014).

2.1.7. Metodologjitë që mbështesin rolin e bashkëpunimit mesues/e-prind gjatë realizimit të aktiviteteve mesimore

Prindërit janë faktorët më përgjegjës për zhvillimin e duhur të fëmijës, për krijimin e një atmosfere të shëndoshë dhe edukative në shtëpi, për organizimin komod të jetës, si dhe për përzgjedhjen me kujdes të metodave të edukimit në familje, në përshtatje me rrethanat familjare dhe veçoritë e fëmijës së vet. Janë disa metodologji të cilat përfshijnë bashkëpunimin e prindërve me institucionet arsimore-edukative në aktivitete siç janë: metodologjia e “Reggio Emilias”, metodologjia “Hap pas Hapi”, metodologjia “Montessori” etj.

2.1.8. Roli i bashkëpunimit të familjes në aktivitete mesimore sipas metodologjisë “Montessori”

Përfshirja e prindërve dhe e familjes në arsimin e një fëmije veçanërisht në nivelet më të reja, është thelbësore për një përvojë pozitive, plotësuese të mundshme në institucion arsimor dhe në shtëpi.

Bazuar në të gjeturat e hulumtimit të bërë nga Epstein (2015) në metodologjinë Montessori bashkëpunimi familje-mesues/e ka rëndësi të madhe, mirëpo më shumë kjo metodologji është përqendruar që familja dhe mesueset të respektojnë potencialin e secilit fëmijë për rritje dhe zhvillim. Pra, këto dy faktorë të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin por jo të ndërhyjnë në punën që zhvillon fëmija. Po ashtu sipas Ealls, (2018) vendosja e partneriteteve shtëpi-institucion arsimor është një përparësi për institucionet Montessori dhe ato jo-Montessori. Mendohet të jenë partneritete më të forta shtëpi-institucion arsimor dhe

të jetë një përfshirje më e madhe e prindërve në arsimin e fëmijëve që ndikojnë pozitivisht në mësimin dhe zhvillimin e tyre sidoqoftë, përfitimet e përfshirjes së prindërve në shkollimin e fëmijëve mund të varen pjesërisht nga fakti nëse përfshirja e prindërve përforcon ose minon institucionin. Për disa fëmijë, shtëpia dhe institucioni janë botë shumë të ndryshme që kanë grupe të ndryshme të pritjeve dhe burimeve. Shkalla në të cilën fëmijët korrrin përfitimet e një edukimi Montessori është me gjasë e ndikuar nga shkalla e përshtatjes midis parimeve Montessori dhe parimeve të prindërve që ata marrin në shtëpi. Sipas Ealls, (2018) termi shtëpi-institucion është përdorur për të përshkruar mospërputhjet midis shtëpisë dhe institucioneve në besime, vlera dhe pritshmëri. Fëmijët Montessori mund të pësojnë mospërputhje midis ambienteve të shtëpisë dhe institucioneve në disa mënyra, nga mënyra në të cilën materialet e tyre ruhen e deri në natyrën e ndërveprimeve të tyre me të rriturit në të dy mjediset. Themelore për arsimin Montessori është supozimi se fëmijët janë të vetë-motivuar të cilët do të lulëzojnë në një mjedis që u ofron një ambient të strukturuar, zhvillimor të përshtatshëm. Ngjashëm me një klasë Montessori, edhe shtëpitë Montessori mund të përfshijnë ambiente të përgatitura që u ofrojnë fëmijëve qasje në zhvillim për shembull, materialet dhe mjetet e duhura pajisjet që janë në nivelin e tyre etj. Maria Montessori dha rekomandime specifike për rolin e të rriturve në jetën e fëmijëve, ata duhet të respektojnë fëmijët dhe të nderojnë lëvizjen e tyre të lindura drejt eksplorimit dhe zotërimit të vetvetes. Prandaj, udhëzimet për mesueset dhe për prindërit janë shumë të ngjashme. Edhe mesueset marrin trajnime të specializuara për të zbatuar në mënyrë efektive parimet e Montessorit, por e njëjta gjë nuk ndodh edhe me prindërit, megjithëse institucionet Montessori zakonisht punojnë nga një kornizë e ngjashme arsimore, ata mund të jenë në ndryshueshmëri më të madhe në përvojat e fëmijëve në shtëpi. Institucionet arsimore mund të nxisin bashkëpunimin shtëpi-institucion në aktivitete mesimore duke inkurajuar përfshirjen e prindërve në ngjarje shkollore ose duke ofruar mundësi të ndryshme si p.sh përmes seminareve për edukimin e tyre apo mbledhjeve që ata të kuptojnë parimet Montessori (Walls, 2018). Edhe sipas Demaio (2018) edukimi i prindërve për vlerën e shkolles në metodologjinë Montessori është një aspekt tejet i rëndësishëm. Ku mesueset marrin kohë për të shpjeguar prindërve aspekte specifike të kurrikulës dhe madje për të demonstruar proceset dhe përfitimet, në mënyrë që prindërit të mund ta vazhdojnë punën në shtëpi. Për fëmijët më të vegjël, mesueset përqendrohen në prezantimin e ushtrimeve praktike, duke treguar nivelin e pavarësisë që po arrijnë këta fëmijë të vegjël. Prindërit shpesh janë të impresionuar nga aftësia e shpejtë motorike dhe zhvillimi social-emocional i fëmijëve që hyjnë në mjediset Montessori. Vëzhgimi i fëmijëve që punojnë gjatë këtyre aktiviteteve dhe mësimi i përparimit të

planifikuar me kujdes të hapave i ndihmon prindërit të realizojnë potencialin e fëmijës së tyre dhe metodën Montessori. Njohjet e prindërve përmirësohen gjithashtu nga rezultatet e dukshme të fëmijëve të tyre, që arrijnë gjatë realizimeve të aktiviteteve mesimore. (Demaio, 2018).

2.1.9. Roli i bashkëpunimit të familjes në aktivitete mesimore sipas metodologjisë “Reggio Emilia”

Sipas Eöortham (2013) pjesëmarrja e prindërve në aktivitete edukative sipas metodologjisë Reggio Emilia është një strategji edukative që shënon mënyrën e të qenurit dhe të bërit institucion. Pjesëmarrja e fëmijëve, familjeve, mesueseve, nuk është thjesht vetëm për të “marrë pjesë” në diçka por më tepër se pjesë e saj, është thelb i saj, pra që përbën një thelb të përbashkët identiteti, një “ne” që e krijojnë përmes pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit të tyre aktivë. Në këtë mënyrë përvoja e prindërve, arsimit dhe pjesëmarrja përzihen së bashku dhe bëhen forma dhe përmbajtje të një procesi të vetëm ndërtimi. Ndërsa duke iu referuar studimit të Mato & Kamani (2000) po ashtu metodologjia Reggio Emilia presupozon një bashkëpunim jetëgjatë të prindërve, mesueseve dhe anëtarëve të komunitetit. Formimi i bindjeve se çfarë është më e mirë për fëmijët dhe familjet e tyre e lehtëson këtë bashkëpunim në të gjitha drejtimet. Në kundërshtim me praktikën e shumë vendeve të tjera, në Reggio Emilia institucioni arsimor nuk shihet si çështje e zëvendësimit të nënës, dhe pse një shumicë fëmijësh vijnë nga familje ku të dy prindërit punojnë. Duke njohur rolin kritik të prindërve, mesueset theksojnë gjithashtu se fëmija është i aftë që në moshë të vogël, që të zhvillojë edhe cilësi të tjera marrëdhëniesh. Mesueset dhe prindërit e konsiderojnë izolimin e fëmijës nga të tjerët si një pengesë për zhvillimin e tij. Prandaj ata, kanë përcaktuar strategjitë formale dhe joformale të vendosjes së një komuniteti të pasur shkëmbimesh. Sipas Mato & Kamani (2000) prindërit bëhen pjesëtarë të realizimit të projekteve që në çastin kur fëmijët e tyre regjistrohen në institucionin arsimor edukativ. Mesueset mbledhin informacionin e nevojshëm për rutinën e secilit fëmijë, preferencave të fjetjes dhe të ngrënies, dëshirës së prindërve për të qëndruar në grup në javët e para të institucionit kur një gjë e tillë ua lejon puna etj. Që me hyrjen e fëmijës në institucion, krijohen albume me foto të anëtarëve të familjes dhe personelit të institucionit arsimor të cilat më pas plotësohen me vëzhgime dhe kujtime; prej klases parashkollore deri në futjen në klasat në vijim fëmijët mund të kenë 3 ose 4 volume të tilla. Ky album shënimesh shërben:

- Si metodë komunikimi mes mesueses dhe prindërve,
- Si dokument për zhvillimin e fëmijës nga një vit në tjetrin,
- Jep të dhëna të rëndësishme të edukimit dhe formimit të fëmijës në këtë periudhë të jetës së tij.

“Suksesi, efektiviteti dhe cilësia e kësaj përvoje janë fryt sidomos i përfshirjes së suksesshme të komunitetit të prindërve në jetën dhe veprimtarinë mesimore të institucionit arsimor. Në konceptimin dhe realizimin konkret të bashkëpunimit mesues-fëmijë-prind, kjo përvojë mbështet dhe shfrytëzon ata faktorë, të cilët po të vlerësohen drejt, krijojnë kushtet e nevojshme për një zhvillim harmonik të fëmijës. (Mato & Kamani, 2000, p. 51).

2.1.10. Roli i bashkëpunimit të familjes në aktivitete mesimore sipas metodologjisë “Hap pas Hapi”

Bazuar në hulumtimet e bëra sipas Kulinxha (2015) familja ka qenë dhe mbetet çdoherë faktor i parë dhe më i rëndësishëm i edukimit. Përfshirja e familjes në procesin e edukimit në kuadër të realizimit të programit “Hap pas Hapi” siguron efekte pozitive, edukative mesimore për çdo fëmijë. Ku fillon me rastin e shkëmbimit të informacioneve ndërmjet kuadrit arsimor dhe prindit, për vetë programin, natyrën e punës, qëllimin, specifikat, por edhe për informacionin rreth rritjes dhe zhvillimit të fëmijës, nevojave të bashkëpunimit me qëllim që t’i shërbejnë atij në mënyrë optimale. Po ashtu sipas Vadahi (2002) kjo metodologji mendon se familjet kanë influencën më të madhe mbi fëmijët e tyre. Ata janë mesuesit e tyre të parë. Familjet duan më të mirën për fëmijët e tyre, duan që ata të jenë krijuar dhe të suksesshëm në të ardhmen, prandaj ato duhet të lejohen të marrin pjesë e të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e edukimit dhe të inkurajohen për të ndihmuar në zhvillimin e eksperiencave në programet mesimore. Sipas Vadahi (2002) çdo institucion që zbaton metodologjinë Reggio Emilia inkurajohet të krijojë një dhomë për prindërit ku pjesëtarët e familjes mund të takohen me mesueset, të lexojnë informacion për fëmijët e institucionit dhe fëmijën e tyre në veçanti për çështje të tilla si shëndeti, disiplina ose tema të tjera që iu interesojnë. Prindërit mund t’i marrin këto materiale edhe në shtëpi në mënyrë që të ruajnë dhe t’i kthejnë sërish ato. Kjo dhomë mund të përdoret edhe për takime me prindër dhe seminare me ta. Familjet mirëpritën në institucion arsimor me qëllim që të punojnë fëmijët, të ndihmojnë në përgatitjen e aktiviteteve dhe të takohen me stafin pedagogjik. Sipas Kulinxha (2015) njohja e prindit me mundësitë e bashkëpunimit, sidomos me mundësitë e bashkëpunimit për organizimin dhe realizimin të vetë procesit edukativ, bën që ai të pranojë obligime dhe përgjegjësi, që ndihmojnë ngritjen e kualitetit të punës së programit dhe gjithashtu të përfitojë prej ndjesisë së qenit pjesë e jetës sociale e institucionit arsimor. Organizimi i manifestimeve të caktuara, si, p.sh., festat e caktuara të vitit, ndihma e familjeve me probleme apo takimet e tjera të rregullta e të rastit, mundësojnë që çdo prind të ndjejë se dashuria dhe përkujdesja, aq të nevojshme për fëmijën, nuk mjaftojnë për zhvillimin optimal të fëmijës pa përvetësimin e disa njohurive profesionale nga mesueset. Nga ana tjetër, asnjë përgatitje profesionale nuk

ndihmon që të plotësojë procesin e edukimit pa ndjenjat e fisnikëruara që ofron familja. Po ashtu një element tjetër shumë i rëndësishëm sipas Vadahi (2002) në metodologjinë “Hap pas Hapi” është edhe këshilli i prindërve i cili mbledhet me stafin pedagogjik për të diskutuar aktivitetet në institucionet arsimore. Ky komitet është i përbërë nga prindër të fëmijëve në institucion, por mund të ketë edhe anëtarë të tjerë të komunitetit. Stafi pedagogjik i metodologjisë “Hap pas Hapi” punon me familjet për të tërhequr një vlerësim mbi nevojat e tyre dhe të realizojë një imazh të qartë për të gjitha familjet që fëmijët e tyre edukohen dhe përgatiten për jetën me këtë metodologji. Ndërsa në anën tjetër sipas Coughlin, et al., (1997) synimi i programit “Hap pas Hapi” është që të krijojë një bashkësi mbështetëse që e mban familjen në qendër dhe përfshin edhe grupin e mesueseve dhe anëtarët e bashkësisë. Sepse ky grup njerëzish krijon një rrjet që planifikon, diskuton dhe komunikon çështje dhe probleme me qëllim që të krijohet një program që ushqen e mbështet rritjen e zhvillimin e fëmijëve dhe familjeve të tyre.

Bazuar në të tri metodologjitë e shtjelluara, arrijmë në përfundim që roli i prindërve në aktivitetet mesimore është shumë e rëndësishme në të tria metodologjitë, sepse çdo prind mund të shikojë zhvillimin e fëmijëve të tyre, të nxisin interesa të ndryshme për fëmijët, si dhe i motivojnë dhe inkurajojnë fëmijët e tyre gjatë zhvillimit të aktiviteteve mesimore sipas mënyrave që secila metodologji rekomandon.

2.1.11. Strategjitë për një bashkëpunim më të mirë

Sipas Federatës Amerikane të Mësimdhënësve (2007) për një bashkëpunim efektiv duhet të përdorim disa strategji siç janë:

Kontakti personal përfshirë konferencat, vizitat në shtëpi, thirrjet telefonike, duket të jenë forma më efektive të komunikimit dhe po ashtu mund të jenë edhe më të familjarizuar. Megjithatë, stabilizimi i bashkëpunimit efikas institucion — shtëpi është bërë më kompleks me ndryshimin e shoqërisë. Diversiteti i madh në mes të familjeve nënkupton që nuk është e mundur të mbështetemi në një metodë të vetme të bashkëpunimit që do t’i arrinte të gjitha shtëpitë me një porosi. Është thelbësore që një llojllojshmëri strategjisë, e përshtatur me nevojat e familjeve të caktuara dhe orareve të tyre, të jetë e përfshirë brenda një plani të përgjithshëm.

2.2. Komunikimi si hap fillestar për bashkëpunimin mësues/e-prind

Komunikimi pozitiv dhe i vazhdueshëm, mësues/e-prind-fëmijë është çelësi kryesor për një bashkëpunim të mirë. Sepse prindi është burimi më i mirë i njohurive për secilin fëmijë dhe partneri më i rëndësishëm, për punën e mësueses, sepse vetëm prindi, ka qëllime ideale, vullnet të madh dhe dëshira për fëmijën e vet. Prindi di më së miri, çfarë di, çfarë do dhe çfarë mund të bëjë fëmija i tij. Gjithashtu njeh më së miri preokupimet, temperamentin dhe personalitetin e fëmijës së vet. Prandaj, ndër kriteret e një bashkëpunimi profesional dhe që ndikon drejtpërdrejt në trajtimin e duhur dhe në zhvillimin e fëmijës, është komunikimi i sinqertë, reciprokisht, në mes të mësueses dhe prindit.

2.2.1. Komunikimi me fëmijët dhe prindërit

Duke iu referuar studimit të bërë nga Vadahi (2002) komunikimi me familjet rreth fëmijëve është një pjesë e rëndësishme e përgjegjësive të personelit mësues. Të gjitha familjet shqetësohen për fëmijët e tyre dhe duan që fëmijët e tyre të mësojnë të lumtur e me plot sukses dhe që të arrijnë këtë qëllim na duhet një bashkëpunim dhe komunikim i mirëfilltë nga të dyja palët. Cikli fillorë shënon përjetimin e parë të fëmijës larg familjes. Anëtarët e familjes dëshirojnë të dinë ecurinë e fëmijës, personeli mësues dëshiron të diskutojë aktivitetet e fëmijës, përparësitë, dobësitë dhe problemet e tjera shqetësuese me familjet, në mënyrë që aktivitetet dhe konceptet të përforcohen në shtëpi. Prandaj komunikimi i hapur dhe efektiv mes mësueses, fëmijëve dhe prindërve është e rëndësishme për përgatitjen e fëmijëve të operojnë në një shoqëri demokratike. Sipas Vadahi (2002) aspekte të veçanta të komunikimit të hapur e efektiv mes prindërve, fëmijëve, bashkëpunësorëve apo njerëzve të tjerë, janë tepër të rëndësishme. Mësuesja duhet të përpqet t'i mëshirojë këta komponentë sa më shumë që të jetë e mundur në marrëdhëniet me të tjerët. Në këtë mënyrë ajo do të përforcojë shprehitë dhe qëndrimet që shpalosen në një shoqëri demokratike si dhe do të krijojë një mjedis demokratik. Po ashtu bazuar në një raport nga Kolucki & Lemish (2011) sa i përket një komunikimi pozitiv ai duhet t'iu adresohet fëmijëve ku hulumtimet nga fusha e shëndetësisë, vlerave ushqyese, psikologjisë, zhvillimit të fëmijës dhe antropologjisë, ndërmjet tjerave, dëshmojnë se të gjitha aspektet e zhvillimit të fëmijëve janë të ndërlidhura. Zhvillimet fizike, sociale,

emocionale dhe të njohjes janë të lidhura në mënyrë të pandarë. Një fëmijë mund të jetë i zgjuar, por jo të jetojë në neglizhencë dhe abuzim. Sipas Kolucki & Lemish (2011) një fëmijë mund të jetë i ushqyer mirë, por të jetë i uritur për dashuri, një fëmijë mund të jetë i dashur por mund të jetë i brishtë fizikisht dhe emocionalisht. Komunikimi që balancon dhe i cili jep vëmendje plotësuese të gjitha nevojave të tyre zhvillimore më së miri iu shërben fëmijëve, duke filluar që nga fëmijëria. Gjithashtu komunikimi për fëmijët duhet të jetë një model pozitiv për kujdestarët dhe në përgjithësi për të gjithë të rriturit që ndërveprojnë me fëmijët.

2.2.2. Ndikimi i komunikimit efektiv në marrëdhëniet mësues/e-prind

Komunikimet pozitive të prindërve dhe institucioneve arsimore sipas Federatës Amerikane të Mësimdhënësve (2007) u sjellin dobi prindërve, mënyra në të cilën institucionet arsimore komunikojnë dhe bashkëveprojnë me prindërit ndikon në shtrirjen dhe cilësinë e përfshirjes së shtëpisë së prindërve me mësimin e fëmijëve të tyre. Për shembull, institucionet arsimore të cilat komunikojnë më shpesh lajme të këqija për performancën e fëmijëve, sesa njohin përsosmërinë e fëmijëve, do të dekurajojnë alternativën e prindërve duke i bërë prindërit të ndjehen se nuk mund t'i ndihmojnë në mënyrë efektive fëmijët e tyre. Prindërit gjithashtu përfitojnë nga përfshirja në arsimimin e fëmijëve të tyre duke marrë ide nga institucioni se si të ndihmojnë dhe mbështesin fëmijët e tyre, dhe të mësojnë më shumë rreth programit akademik të institucionit dhe si funksionojnë. Ndoshta më e rëndësishmja, prindërit përfitojnë duke u bërë më të sigurt për vlerën e përfshirjes së tyre në institucion. Prindërit zhvillojnë një vlerësim më të madh për rolin e rëndësishëm që luajnë në edukimin e fëmijëve të tyre. Në anën tjetër sipas Selimi (2012) një ndër veçoritë më të rëndësishme të një bashkëpunimi të frytshëm të prindërve me mësuesene fëmijës është kur komunikimi mes tyre nuk kufizohet ose nuk reduktohet në informata dhe situata të rastit dhe sipërfaqësore për fëmijën, por zhvillohet në mënyrë partneriteti dhe është transparent. Një bashkëpunim i tillë nuk bën të reduktohet vetëm në dorëzimin e ndonjë fletushke informative, e cila, për shkaqe gjuhësore, ndoshta nuk kuptohet ose nuk lexohet fare.

Sipas Selimi (2012) përkundrazi prindërit duhet të:

- Të kërkojnë biseda, me ç'rast mund të flasin mbi zhvillimin gjuhësor dhe social të fëmijës,
- Të pyesin për shembuj konkretë dhe forma të ndryshme të cilat praktikohen në institucion apo në grup loje dhe të cilat mund të praktikohen nga prindërit në

familje,

- Të ofrojnë shembuj dhe ide të veta, të cilat do të zgjojnë interes te fëmija, do t'u përgjigjen preferencave të fëmijës etj (p. 36).

Hapa të këtillë jokonvencionalë janë të vlefshëm në radhë të parë për fëmijën, kurse më pastaj edhe për prindërit dhe për mësuesen. Pjesëmarrja aktive e prindërve në proceset mësimore dhe edukative pa dyshim paraqet një ndihmesë të rëndësishme dhe të frytshme për fëmijën. Prandaj, ndihmesa e tillë gjithsesi vlen që të shfrytëzohet në mënyrë aktive, sepse kështu do të përforcohet bashkëpunimi mes prindërve dhe mësueses. Pra, në këtë mënyrë mundësohet zhvillimi i një bashkëpunimi të sinqertë, pa paragjykime, me plot respekt e i gjallë, i cili në fund të fundit, është në interes dhe në të mirë të të gjithëve (Selimi, 2012).

2.3. Bashkëpunimi mësuese/e -prind në aktivitete edukative

Duke u bazuar në studimin e bërë nga Sahin, Inal, & Ozbey (2011) prindërit kanë një rol kryesor në realizimin e aktiviteteve mësimore në shkollat fillore . Përfshirja e prindërve i mundëson institucionit të ruajë detyrat e tij arsimore në mënyrë efikase. Institucioni bëhet më cilësor në arritjen e qëllimeve të saj arsimore duke bashkëpunuar me prindërit. Fëmijët gjatë pjesëmarrjes së prindërve në aktivitete nuk e konsiderojnë institucionin të izoluar nga prindërit dhe fitojnë vetëbesim. Për më tepër, ata janë të kënaqur edhe emocionalisht. Edhe sipas studimit të Henry & Friesen (2018) rikonfirmohet se marrëdhëniet dhe bashkëpunimi i fëmijëve me të rriturit është shumë i rëndësishëm në jetën e tyre ku kanë një ndikim të madh në zhvillimin e hershëm të trurit dhe të nxënit e vazhdueshëm. Për shumicën e fëmijëve, anëtarët e familjes janë kujdestarët kryesorë që ofrojnë këtë bazë të rëndësishme. Kur fëmijët hyjnë në programet mësimore të arsimit fillore , partneritete të forta midis shtëpisë dhe institucioneve mund të mbështesin marrëdhënie pozitive në familje dhe të promovojnë të nxënit në shtëpi. Sipas Sahin, Inal, & Ozbey (2011) përmes përfshirjes së prindërve në aktivitete mësimore, fëmijët gjithashtu kanë mundësinë të njohin prindërit e tjerë dhe të komunikojnë me ta. Këto aktivitete gjithashtu i mundësojnë që mësueset të njohin më ngushtë prindërit, dhe të ndërmarrin nismën për të ndihmuar fëmijët kur është e nevojshme. Gjithashtu edhe aktivitetet mësimore të përfshirjes së prindërve janë të rëndësishme për fëmijët pasi që ato përbëjnë një bazë për arritjet akademike në vitet e mëvonshme. Kontributi më thelbësor i përfshirjes së prindërve është se ai u mundëson prindërve të kërkojnë të drejtat e fëmijëve, gjë që rrit ndërgjegjësimin e

tyre për të mbështetur fëmijët e tyre në institucion dhe në shtëpi. Pra, aktivitetet ku përfshihen prindërit forcojnë, prindërit që ata të luajnë një rol kryesor për të bërë ndryshime në shoqëri, veçanërisht në fëmijët e tyre.

Po ashtu bazuar tek një raport nga Shehu, et al., (2014) nga zbatimi i standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm, mësueset e institucioneve arimore janë plotësisht të vetëdijshëm se mësuesit e parë dhe me më shumë ndikim të fëmijëve janë prindërit e tyre, andaj duhet të krijojnë atmosferë të përgjithshme të respektit të ndërsjellë, si për prindërit ashtu edhe për fëmijët. Mësueset duhet të bashkëpunojnë në mënyrë intensive me prindërit në të gjitha aktivitetet që i ndërmarrin në institucione arimore dhe t'u ndihmojnë në mënyrë aktive prindërve për vazhdimin e aktiviteteve për mësim të hershëm edhe në shtëpi (Shehu, et al., 2014). Familjet duhet të konsiderohen si specialistë për fëmijët e tyre dhe pjesëmarrës aktivë në procesin e edukimit të fëmijëve të tyre. Respekti dhe komunikimi i hapur lidhur me strategjinë e aplikuar synimet procedurat dhe aktivitetet e programit ndihmesa në planifikim dhe perspektivat e qarta familjare ndihmojnë që gjithsecili të ndjehet se i përket metodologjisë të cilën e ndjekin fëmijët duke i hapur rrugën një edukimi të hapur dhe premtues (Vadahi, 2002). Sepse pa diskutim që kur është një bashkëpunim i mirë ndërmjet mësueses dhe prindërve edhe fëmijët do të ndihen më mirë, kanë mundësi të marrin vendime të gjithë së bashku, të pyesin dhe të shprehin lirshëm, lidhja e tyre të jetë më e fortë etj. Partneriteti bazohet në mirëkuptimin e ndërsjellë dhe njohjen e asaj që e presin ata nga njëri-tjetri, si dhe në njohjen e ndërsjellë të qëndrimeve me të cilat disponojnë edhe njëra edhe pala tjetër. Partneriteti i bazuar në besim të ndërsjellë dhe interes të përbashkët krijon atmosferë që shpie në përvoja pozitive të mësimin të fëmijët e vegjël, si në institucion, ashtu edhe në familje. Mësueset mund të bëjnë shumë që t'i inkurajojnë prindërit për pjesëmarrje aktive në mësimin dhe realizimin e aktiviteteve mësimore të fëmijëve të tyre. Njëra nga strategjitë është që t'u ndihmojnë prindërve ta kuptojnë se aktivitetet për mësim, që zbatohen në institucione, paraqesin kombinim të aktiviteteve që iniciohen nga përvojat e fëmijëve dhe aktivitetet që udhëhiqen nga vetë mësuesët (Shehu, et al., 2014).

Edhe në studimin e bërë nga Kurtulmus (2016) të gjeturat tregojnë se përfshirja e prindërve shpjegohet si pjesëmarrje në proceset edukative dhe arimore të fëmijëve të tyre. Aktualisht në hulumtime të bazuara në prova sugjerojnë tre dimensione të përfshirjes së familjes në promovimin e rezultateve të shëndetshme siç janë: prindërit, institucionet, marrëdhëniet shtëpiake dhe përgjegjësia për rezultatet e të nxënit. Prindërimi është dimensionimi i përfshirjes së prindërve që përfshin qëndrimet, vlerat dhe praktikat e

prindërve në rritjen e fëmijëve të tyre. Prindër i përgjegjshëm është kur krijon marrëdhënie të mira, në aktivitete edukative dhe janë të përqendruar ndaj fëmijëve të cilat këto krijojnë rezultate pozitive të mësimin në fëmijërinë e hershme. Gjithashtu edhe pjesëmarrja në aktivitete mësimore përmes lojës është e rëndësishme për zhvillimin social dhe emocional të fëmijëve. Fëmijët që luajnë në shtëpi me prindërit e tyre, të cilët pra i japin rëndësi lojës në realizimin e detyrave të ndryshme në zhvillimin e tyre ata fëmijë kanë të ngjarë të demonstrojnë sjellje prosociale dhe të jenë të pavarur në klasë. Pjesëmarrja e prindërve me fëmijët e tyre në arte dhe aktivitetet artizanale gjithashtu ka një ndikim në arsimimin e fëmijëve dhe në zhvillimin e tyre po ashtu.

2.3.1. Kur ndodh përfshirja e prindërve dhe angazhimi familjar?

Sipas Ingram, Eolfe, & Lieberman (2007) shkak i arritjeve të fëmijëve në të nxënë është përfshirja e prindërve në shtëpi dhe institucion ku përfshijnë diskutimet dhe përvojat e tyre. Po ashtu sipas Bierman, Morris, & Abenavoli (2017) mund të konstatojmë se përfshirja e prindërve ndodh kur prindërit marrin pjesë në aktivitete dhe përfitojnë mundësi për kujdesin dhe realizimin e aktiviteteve mësimore të fëmijës së tyre. Kjo do të thotë që prindërit marrin pjesë në takime ose ngjarje speciale që një program ofron në shkollë. Përfshirja e prindërve gjithashtu mund të përfshijë një shkëmbim të informacionit për fëmijën dhe çfarë ndodh në shtëpi. Këto informacione janë të rëndësishme dhe shumë të dobishme për të dy palët si për prindërit ashtu edhe për mësueset. Gjithashtu prindërit duhet të bisedojnë me mësueset kur arrijnë fëmijët në institucion arsimorë dhe gjatë daljes së fëmijës nga institucioni, kur prindërit marrin pjesë gjatë shoqërimit të fëmijëve, kur marrin pjesë në takime, kur personeli shtron pyetje në lidhje me fëmijën e tij/ saj familjen dhe jetën në shtëpi, po ashtu kur stafi ofron ide për burime për familjet që do t'i përdorin në shtëpi dhe në komunitet, kur familjet ndajnë sugjerime dhe konkluzione me stafin, gjithashtu kur stafi me familjen punojnë së bashku për të krijuar aktivitete që pasqyrojnë traditat kulturore të familjeve në program, kur familjarët janë vullnetarë për aktivitete udhëheqëse dhe japin informacion të vazhdueshëm dhe domethënës për programimin (Bierman, Morris, & Abenavoli, 2017). Po ashtu një nga parimet kryesore që duhet të jetë në qendër të programeve mësimore është angazhimi i familjeve dhe komuniteteve. Është me rëndësi të angazhohet i gjithë komuniteti në rritjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve. Rëndësi tjetër ka edhe inkurajimi i të gjithë llojeve të pjesëmarrjes së familjeve në institucion arsimorë (Vadahi, 2002). Sipas Bierman, Morris, & Abenavoli (2017) angazhimi familjar ndodh kur fëmijët apo nxënësit, profesionistët dhe familjet përfshihen në një proces interaktiv të krijimit të marrëdhënieve. Në anën tjetër sipas një studimi të bërë nga Hughes & Këok (2007) ekzistojnë prova që tregojnë se cilësia e marrëdhënies

mësuese-prind ndikon në përpjekjet e prindërve për të angazhuar fëmijët e tyre në diskutime, në zhvillime të aktiviteteve ku këto angazhime rritin performancën e fëmijëve. Po ashtu autorët Bierman, Morris, & Abenavoli (2017) theksojnë se ndërtimi i kuptimit të marrëdhënieve është në vazhdim dhe kërkon kohë dhe vëmendje pra duhet që mësueset të kenë qasje dhe partneritet me familjet për të ndarë përgjegjësi për kujdesin dhe mësimin e fëmijëve, për shembull kur një mësuese punon me një prind për të planifikuar, për të mbështetur fëmijën për të realizuar aktivitetet mësimore etj. Angazhimi në shkollën fillore përgatit familjet që të angazhohen gjatë gjithë periudhës kur fëmijët janë në institucion arsimorë. Më e rëndësishmja, përpjekjet e angazhimit familjar mbështesin marrëdhëniet prind-fëmijë që janë thelbësore për një zhvillim të shëndetshëm të fëmijëve, gatishmërisë në shkollë dhe mirëqenies tani dhe në të ardhmen.

2.3.2. Motivimi i prindërve për të bashkëpunuar në shkollën fillore

Termi bashkëpunim mësues/e-prind përfaqëson një urë lidhëse përpara njohurive që fëmijët marrin në institucionet arsimore dhe duke mësuar në shtëpi. Faktori më me përgjegjësi për formimin e një personaliteti si të tërësishëm e të shëndoshë ose si personalitet i paadaptuar mirë është familja, pra familja është qelizë e jetës shoqërore, ku detyrë themelore e së cilës është ta edukojë, mësojë e formojë gjeneratën e re. Dhe si obligim i institucioneve arsimore është që t'i motivojnë dhe inkurajojnë prindërit për të bashkëpunuar gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore (Zuna, 2003). Në shumë raste, si prindërit ashtu edhe mësueset kanë fajësuar njëri-tjetrin për problemet dhe për vështirësitë në institucionet arsimore, përderisa zgjidhja mund të gjendej vetëm nga puna në ekip. Në mënyrë që të motivohen prindërit për një bashkëpunim me institucionet arsimore, duhet të kenë ndikim institucioni dhe mësueset. Në takimet e prindërve, mësuesja duhet të influencojë prindërit, që të ndihen rehat për shkak të fëmijës së tyre dhe të aftësive prindërore. Atëherë prindërit dhe edukatorët si ekspertë, në bashkëpunim, mund të gjejnë një zgjidhje të lehtë për fëmijën. Me një fjalë, motivimi i prindërve për bashkëpunim varet nga aftësia e një mësuese për të angazhuar prindin në mbështetje të të nxënit të fëmijës. Këtë e arrin nëpërmjet komunikimit me secilin prind në mënyrë pozitive, si dhe duke e vlerësuar kontributin e tyre në mbështetje të fëmijës në institucione arsimore (Bicaj, Bytyqi, Azizi, & Xhemajli, 2018).

2.3.3. Praktikat pozitive të përqendrimit dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë

Gjatë seancave të shumta, prindërve u mësohet se si ta përqendrojnë vëmendjen te fëmijët e tyre, të vendosin pritshmëri të qarta, të përdorin lavdërime për të forcuar sjelljen e fëmijëve dhe vendosja e kufijve në mënyrë efektive për të zvogëluar konfliktet. Praktikat

pozitive të prindërve për fëmijët të shkollës fillore përqendrohen tek promovimi i gatishmërisë së mësimit të fëmijëve. Këto praktika zakonisht bëhen individualisht gjatë vizitave në shtëpi, ose përmes një seri takimesh të grupeve të prindërve të bazuar në institucion arsimorë. Prindërve u jepet material mësimor dhe u tregohet se si t'i përdorin ato për t'i ndihmuar ata, sepse fëmijët kënaqen të mësojnë diçka të re sidomos nga prindërit e tyre. Këto praktika pozitive rrisin gatishmërinë e fëmijëve nga pasurimi me materiale mësimore të disponueshme në shtëpi dhe duke përmirësuar cilësinë e bashkëveprimeve prind-fëmijë në mënyrë që të nxisin aftësitë e të menduarit, motivimin e të mësuarit, dhe në disa raste vetë-rregullimin dhe socializimin e fëmijëve (Bierman, Morris, & Abenavoli, 2017).

2.3.4. Si të mësoj për ecurinë e fëmijës sim në institucion arsimor?

Sipas Tahsini, Duci & Voko (2014) ekzistojnë disa mënyra si mund të informohemi nga mësuesja për përparimin e fëmijës suaj si dhe për programin që ndjek institucioni arsimorë p.sh. mbledhjet periodike të prindërve në ambientin e institucionit arsimor, ku bashkëbisedohen tema rreth funksionit dhe programit të institucionit, konsultimet e shkurtra të përditshme me mësuesen, kur prindërit sjellin ose marrin fëmijët e tyre nga institucioni, takimet e posaçme individuale të prindërve me mësuesen, ku u jepet mundësia të bisedojnë së bashku çështje që kanë të bëjnë me fëmijën e tyre, kontakte telefonike me mësuesen në telefonin e institucionit arsimor kur ekziston ndonjë arsye konkrete po ashtu edhe takime informuese me specialist në fushën e arsimit, në të cilat bisedohen temat që u interesojnë prindërve gjithashtu përveç rasteve të cekura më lart sigurisht që gjithmonë është mundësia e bisedës me mësuesen kur ka prindi ndonjë nevojë urgjente (Tahsini, Duci, & Voko, 2014).

2.3.5. Si mund të marrin pjesë prindërit në aktivitetet mësimore të institucionit arsimor?

Po ashtu sipas Tahsini, Duci, & Voko (2014) bashkëpunimi midis institucionit arsimorë dhe familjes ka shumë dobi për fëmijët. Më e rëndësishmja është se krijon një vijim për gjithçka që ndodh midis dy ambienteve ku jeton, vepron dhe të nxënit çdo ditë nga fëmija. Gjatë vijimit në institucion arsimorë fëmija ka nevojë për ndihmën e prindërve dhe bashkëpunimin me ta. Dhe janë disa mënyra ku mund të bashkëpunojnë së bashku për shembull mund të sjellin në institucion arsimorë disa objekte, libra ose informacione nga shtëpia që kanë të bëjnë me tema që u interesojnë fëmijëve dhe me të cilat merren në atë periudhë në institucion arsimorë. Gjithashtu në bashkëpunim me mësuesen, mund të marrin prindërit pjesë në disa veprimtari të institucionit, të ndihmojnë në ndonjë aktivitet

ose të ofrojnë dijet apo eksperiencat e tyre rreth çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me aktivitete mësimore etj.

2.3.6. Roli i prindërve gjatë bashkëpunimit me mësuesen apo mësuesin në realizimin e aktiviteteve edukative

Sipas raportit të Tahsini, Duci, & Voko (2014) prindërit kanë nevojë të ndiejnë mbështetjen e mësueseve, ata duhet të informohen mbi gjithçka që lidhet me fëmijën, po ashtu mësueset duhet t'u përgjigjen nevojave të prindërve për të qenë të informuar lidhur me çdo gjë që ka të bëjë me fëmijën e tyre, pasi që prindërit njohin më mirë se kushdo fëmijën e tyre duhet të dëgjojnë me shumë kujdes dhe vëmendje udhëzimet apo çfarëdo tjetër lidhur me fëmijët e tyre dhe institucionin arsimorë që ndjek, për të pasur sukses një bashkëpunim i tillë prania dhe pjesëmarrja e prindërve në aktivitete mësimore duhet nxitur dhe inkurajuar nga stafi i institucionit arsimorë. Mësueset duhet të diskutojnë me prindërit për shumëllojshmërinë e aktiviteteve mësimore që fëmija duhet të kryejë në familje, pra prindërit në ditë të caktuara, mund të vijjnë më herët në institucion arsimorë për të parë se si fëmijët e tyre përfshihen në aktivitete mësimore, se si ata i zbatojnë rregullat, si bashkëpunojnë etj, dhe përmes kësaj pjesëmarrje prindërit mund të shohin progresin e fëmijëve dhe vështirësitë e fëmijëve me të cilat ata ndeshen.

2.3.7. Pjesëmarrja e prindërve në aktivitete praktike

Po ashtu sipas Tahsini, Duci, & Voko (2014) prindërit mund të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme lidhur me fëmijët e tyre, mësueset mund të ndajnë me prindërit çdo etapë të rritjes, zhvillimit, edukimit dhe ndërhyrjeve tek fëmijët në të njëjtën kohë mësueset mund t'u përcjellin prindërve qetësinë, besimin dhe sigurinë se fëmijët e tyre janë në duar të sigurta. Ndërmjet familjes dhe institucionit arsimorë nuk duhet të ketë korniza, duhet të ketë aftësi të mira dialogu dhe mirëkuptim reciprok, prindërit ndonjëherë shfaqin qëndrime tepër mbrojtëse ndaj fëmijëve, duke i penguar ata të krijojnë disa eksperiencë të domosdoshme për të zhvilluar aftësitë e tyre. Sipas Tahsini, Duci, & Voko (2014) është e nevojshme që brenda institucionit arsimorë, prindërve t'u krijohet një mjedis ku ata të mund të flasin për të gjitha shqetësimet, nevojat, problemet dhe dëshirat që kanë lidhur me fëmijët e tyre. Ata duhet të ndajnë me njëri-tjetrin përjetimet dhe eksperiencat e të mësojnë nga përvoja dhe praktika të suksesshme. Gjithashtu prindërit mund të përfshihen në aktivitete me karakter social-edukativ, mësimorë si p.sh. ekskursione, shëtitje, ekspozita pikturë, vajtje në cirk, në kinema etj. Në të njëjtën kohë prindërit mund të përfshihen në jetën e institucionit arsimorë edhe si asistentë, pra të marrin pjesë në aktivitete mësimore, të vëzhgojnë se ç'ndodh brenda klasës, të vëzhgojnë mënyrat se si fëmija përfshihet në

aktivitete, si i merr dhe si i zbaton instruksionet etj. Po ashtu prindërit mund të ndahen në grupe për t'i shërbyer më mirë fëmijës dhe për të bashkëpunuar më afër me mësueset. Sepse nëse nuk ka një bashkëpunim të tillë atëherë familja dhe institucioni arsimorë nuk mund të realizojnë misionin e tyre të plotë e të suksesshëm me njëri-tjetrin (Tahsini, Duci, & Voko, 2014). Pjesëmarrja e prindërve në institucion arsimorë kontribuon në zhvillimin më të mirë të fëmijës, dhe për fëmijën kjo është shumë e rëndësishme sepse kur shikon që institucioni arsimorë ku ai merr pjesë në të dhe familja kanë marrëdhënie harmonike mes tyre në këtë mënyrë fëmija ndihet më i sigurt dhe jep rezultate më të mira në zhvillimin e tij. Pra, prindërit janë personat më të rëndësishëm në jetën e një fëmije, prandaj pjesëmarrja e tyre në aktivitete mësimore është e domosdoshme.

2.3.8. Aktivitetet mësimore në shtëpi të mbështetura nga prindërit

Sa i përket përfshirjes së prindërve në realizimin e aktiviteteve mësimore në shtëpi nga një studim i bërë nga Rahman, Choëdhury, & Obaydullah (2019) të gjeturat tregojnë që prindërit i ndihmojnë fëmijët në realizimin e aktiviteteve mësimore, i inkurajojnë ata, ofrojnë mundësi për të luajtur, kënduar, kërcyer dhe manipuluar me material të ndryshme. Në anën tjetër sipas një raporti nga Tahsini, Duci, & Voko, (2014) është e rëndësishme që përpjekja që bëhet në institucione arsimore të përkrahet dhe të fuqizohet nga shtëpia. Loja është mënyra më fuqishme dhe më rezultative e të mësuarit për fëmijën e cila e ndihmon të njohë më mirë botën rreth tij. Është themelore, të keni gjithmonë parasysh nevojën e fëmijës për lojë dhe të përdorni raste që e fuqizojnë atë. Mirë është të krijoni vend dhe të lini kohë për lojë, të luani bashkë me fëmijën tuaj, ta sillni në kontakt me moshatarë, etj. Sidomos kontakti dhe loja me fëmijë të tjerë ndihmon në socializimin e tij sepse mëson të ndajë, të dëgjojë dhe të respektojë nevojat e të tjerëve. Gjithashtu mund të shfrytëzoni momente të përditshme që të përfshini fëmijët në aktivitete zbavitëse, por dhe mësimdhënëse, si: gatimi dhe blerja në super market, ku fëmija vjen në kontakt me shkronjat, numrat dhe informacionet sociale të nevojshme. Kurse sipas Dolya (2010) një mënyrë tjetër shumë e rëndësishme për të bashkëpunuar me prindërit është përmes paketës së aktiviteteve “ide për prindër”. Të cilat mësueset thjesht mund t'u sigurojnë prindërve të gjithë paketën, ose t'u sigurojnë atyre aktivitete nga paketa që janë të rëndësishme për punën e javës në vazhdim, p.sh. duke vendosur një grumbull fotokopjesh në dispozicion në zonën e prindërve. Paketa ofron një numër të madh përfitimesh që janë të rëndësishme si për fëmijët ashtu edhe për prindërit. Ajo i mban prindërit të informuar në lidhje me punën që bëjnë fëmijët e tyre gjatë seancave për qëllimin e mësimit. Po ashtu përgatit prindërit për fjalët e gjata që fëmijët e tyre do të përdorin gjithashtu edhe pyetjet që provokojnë mendimin që ata me shumë gjasë do të fillojnë të shtrojnë. Më e rëndësishmja,

ai u siguron prindërve mënyra praktike për t'u përfshirë në mënyrë aktive në mësimin e fëmijëve të tyre, përmes lojërave dhe aktiviteteve të këndshme mësimore, të lidhura me çdo aspekt të kurrikulës i cili është çelësi për të mësuar. Shumë nga aktivitetet mund të kryhen pa pajisje, p.sh. ndërsa shëtitni një fëmijë në shkollë ose udhëtoni në dyqane. Të gjitha punët i përforcojmë te cilat janë realizuar në klasë. Sidoqoftë, në rastin ideal, mësueset do të përdorin paketën si një mjet për ndërtimin e një partneriteti pozitiv me prindërit. Një takim në lidhje me paketën e aktiviteteve është e rëndësishme për të marrë pjesë. Aktivitetet mësimore ofrojnë një fokus praktik që e bën të lehtë prezantimin e prindërve me idetë për të mësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, e jo kërcënuese. Mësueset mund të modelojnë përdorimin e veprimtarive të ndryshme në mënyrë praktike, duke theksuar nevojën për të shmangur mërziçjen ose detyrimin e fëmijëve. Ata mund t'i inkurajojnë prindërit të shohin idetë në libër si nxitje për veprimtari dhe jo si një grup kërkesash - detyra të shtëpisë që duhet të kryhen në mënyrë të ngurtë, ata mund të diskutojnë mbi rëndësinë e angazhimit të fëmijëve, ata mund të demonstrojnë strategji për sigurimin e angazhimit p.sh. duke krijuar situata imagjinare që ofrojnë mënyra për zgjidhjen e një problem, ata mund të diskutojnë edhe për nevojën që t'i lënë fëmijët të marrin iniciativën për të vendosur se si zhvillohet një veprimtari, gjithashtu mund të theksojnë se sa përfitojnë të gjithë kur prindërit i shohin aktivitetet si mundësi për lojë të përbashkët, në vend se të përcaktojnë materiale dhe ta lënë fëmijën vetëm të fillojë me të. Duke modeluar dhe diskutuar lojën e duhur zhvillimore, mësueset mund të ndikojnë në idetë e prindërve për mësimdhënien dhe mësimnxënien, i ndihmojnë ata të bëjnë zgjedhje të informuara mirë, dhe i frymëzojnë për të zgjeruar aktivitetet mësimore të ofruara dhe për të dalë me ide të mahnitshme, të reja të tyre (Dolya, 2010)

2.3.9. Avantazhet e përfshirjes së prindërve në institucione arsimore

Sipas McDoëll, Jack, & Copmton (2018) përfshirja e prindërve në institucione mësimore jo vetëm që kontribuon në arritjet akademike të fëmijëve por ndikon edhe në fusha të ndryshme të zhvillimit të fëmijëve. Hill & Craft (2003) pohojnë se kompetenca sociale tek fëmijët lidhet drejtpërdrejt me rritjen e përfshirjes së prindërve. Po ashtu Larocque, Kleiman, & Darling (2011) theksojnë se përfshirja në institucione arsimore është e dobishme edhe për prindërit sepse ata janë më të vetëdijshëm për nevojat arsimore të fëmijëve të tyre, gjatë përfshirjes së tyre në institucione arsimore prindërit mund të zhvillojnë marrëdhënie dhe qëndrime më pozitive me mësueset dhe mund të krijojnë mundësi më të madhe në angazhimin e fëmijëve të tyre në aktivitete mësimore. Sipas Hill & Taylor (2004) për shkak që kërkesa për përgjegjësi të prindërve është më e madhe se kurrë në fushën e arsimimit dhe edukimit është thelbësore që institucionet arsimore dhe

familjet të ndajnë përgjegjësinë dhe të krijojnë partneritete për të siguruar që çdo fëmijë të jetë i suksesshëm.

2.3.10. Disavantazhet e përfshirjes së prindërve në institucione arsimore

Sipas një studimi të bërë nga McDoëll, Jack, & Copmton (2018) ekzistojnë disa faktorë që krijojnë barriera dhe pengojnë prindërit të mos përfshihen në edukimin e fëmijëve të tyre. Këto pengesa përfshijnë varfërinë/statusin socio-ekonomik, raca, etnia, dallimet kulturore, pengesat gjuhësore, niveli i arsimit të prindërve dhe kufizimet logjistike. P.sh. prindërit që kanë statusin socio-ekonomik më të ulët shpesh përballen me orare pune që nuk i lejojnë përfshirje, u mungojnë burimet e nevojshme për t'u përfshirë siç janë paratë, transporti, etj. Po ashtu në bazë të hulumtimit të Lopez (2001) edhe vlerat socio-kulturore janë barrierë tek disa prindër për mos përfshirje p.sh. edhe pse mundohen prindërit që t'u ndihmojnë fëmijëve dhe të përfshihen në institucion, ky lloj i përfshirjes mund të mos përfaqësohet dhe nuk kuptohet me lehtësi nga shoqëria kryesore. Sipas Larocque, Kleiman, & Darling (2011) edhe pengesat gjuhësore janë një pengesë apo barrierë për përfshirjen e prindërve p.sh. mospërputhja e gjuhës nëse nuk flitet gjuha e njëjtë ku kjo pengesë mund të jetë shumë shqetësuese për prindërit. Mungesa e arsimimit të prindërve mund të paraqesë po ashtu pengesë në bashkëpunimin e prindërve me mësuese, sepse prindërit mund të mos e vlerësojnë arsimin për shkak të mungesës së suksesit të tyre në shkollë (Larocque, Kleiman, & Darling, 2011). Ose prindërit mund të kenë një mendim negativ për shkollën nga përvojat e tyre vetanake (Lee & Bowen, 2006). Po ashtu edhe kufizimet logjistike mund të jenë barrierë për përfshirjen e prindërve siç janë pra oraret e punës jo fleksibil që mund të pengojnë fizikisht prindërit për të qenë të përfshirë. Sepse të ardhurat e familjes varen nga puna që prindërit kryejnë dhe përfitimet e tyre dhe kjo pra e bën të vështirë pjesëmarrjen e tyre në aktivitete mësimore apo në takime me institucionin arsimorë (Larocque, Kleiman, & Darling, 2011).

2.3.11. Sugjerime për të ndihmuar familjet të kuptojnë vlerën e mësimin dhe të përfshihen në realizimin e aktiviteteve mësimore

Rëndësia e mësimin në zhvillimin e fëmijëve konsiderohet si një komponent thelbësor për zhvillimin e tyre. Nëpërmjet mësimin fëmija rritet, zhvillohet, mëson shprehi të reja etj. Duke marrë parasysh këtë nevojë tek fëmijët, familja të cilët janë pjesa më e rëndësishme e tyre duhet të kuptojnë vlerën dhe rëndësinë e saj. Sipas autorit Bongiorno (2018) janë disa sugjerime që mund ndihmojnë familjet që të kuptojnë vlerën e mësimin dhe të

përfshihen në të. Të përdorim fjalë që do t'i ndihmojnë prindërit të kuptojnë mësimin, të nxëniet dhe zhvillimin, të përshkruajmë lloje të ndryshme shfaqjesh për të zgjeruar familjen duke kuptuar se çfarë është mësimi, gjithashtu të ofrojmë mundësi për të analizuar lidhjet midis saj, të nxëniet dhe zhvillimit, të sigurojmë kohë që prindërit të vëzhgojnë fëmijën, të përfshihen në mësim dhe të reflektojnë në të nxëniet dhe zhvillimin e tyre. Po ashtu të postojmë imazhe të fëmijëve që mësojnë - brenda dhe jashtë, në të njëjtën kohë t'i ofrojmë informacione rreth asaj që fëmijët mësojnë, dhe shumë e rëndësishme është që tu shpjegojmë materialet kryesore të mësimin në mjedisin tonë arsimorë dhe si t'i përdorni ato në shtëpi gjatë implementimit në aktivitetet mësimore.

2.4. Shpjegimi i nocioneve bazë

Shpjegimi i nocioneve bazë na mundëson që të kuptojmë ngjashmëritë dhe dallimet e nocioneve, të kuptojmë fjalën bashkëpunim dhe të kuptojmë nocionet e përafërta që kanë të bëjnë me rolin e bashkëpunimit mësuese/e — prind në realizimin e aktiviteteve mësimore në shkollat fillore.

2.4.1. Nocioni bashkëpunim

Sipas Zuna & Bashkautorët (2009) ky nocion është sinonim i nocionit partneritet apo edhe nocionit kooperim e krahasim. Domethënia e këtij nocioni është “punë e përbashkët me dikë tjetër për të kryer një punë” (p. 17). Sintagma bashkëpunim edukativ ka kuptimin e involvimit të më shumë faktorëve në procesin e edukimit, faktorë këta të cilët mund të jenë “të planifikuar dhe të paplanifikuar, të kontrolluar e të pakontrolluar, të vazhdueshëm apo të herëpashershëm, shoqëror apo individual” (p. 17) që synojnë realizimin e qëllimeve të edukimit.

2.4.2. Nocioni familje

Familja është grup themelor shoqëror, qelizë e shoqërisë e cila themelohet me martesën e individëve të gjinive të ndryshme me qëllim të plotësimit të nevojave jetësore, biologjike, emotive, ekonomike, sociale dhe edukative të anëtarëve të saj. Familjen e karakterizon intimiteti i jetës, vitaliteti dhe uniteti i funksioneve të saja. Pra, familja është çelësi apo hapi i parë ku fëmija mbështetet në fillimet e tij, ndikimi i familjes dhe institucionit janë hapi i dytë për fëmijën në zhvillimin dhe krijimin e tij si qenie njerëzore e shoqërore (Zuna & Bashkëautorët, 2009).

2.4.3. Nocioni institucion arsimor

Sipas Ligjit mbi edukimin Nr. 02/ L-52 (2006) institucionet arsimore mund të definoohen si objekte apo shtëpi të konvertuara të cilat janë të ndërtuara në mënyrë speciale për të ofruar programe të ndryshme mësimore të cilat plotësojnë nevojat edukative, mësimore.

2.4.4. Nocioni mësues/e

Sipas Kulinxha (2015) mësuesja është organizatore, planifikuese dhe realizuese e punës edukativo-arsimorë, është faktor me rëndësi që ndikon për zhvillimin e tërësishëm të personalitetit të fëmijës. Duke qenë se në vazhdimësi nisin dhe drejtojnë aktivitete, “bashkëveprojnë me fëmijët gjatë aktiviteteve dhe lojës, ato modelojnë sjellje mbështetëse e përkujdesje, ato observojnë dhe dëgjojnë fëmijët në qendra të aktiviteteve, gjithashtu regjistrojnë dhe vlerësojnë observimet e tyre”, themi se është autoritet shumë unik që ndikon në realizimin e detyrave edukative në mjedisin e caktuar. Po ashtu sipas Neësom & Vincent (2015) nocioni mësues/e është një faktor me ndikim në bërjen e fëmijës, atë që është tani dhe në përcaktimin e asaj që do të jetë në vitet në vijim.

2.4.5. Nocioni aktivitete mësimore

Sipas MASHT (2014) aktivitetet mësimore janë shembuj të thjeshtë të cilat mund të realizohen nga të gjithë individët që janë afër me fëmijët. Zhvillimi dhe realizimi i tyre, nxitë dhe siguron arritjen e treguesit. Shembujt e dhënë në aktivitete mësimore mund të shërbejnë si udhërrëfyes apo modele edhe për shembuj të tjerë të aktiviteteve që i shërbejnë qëllimit të njëjtë. Po ashtu bazuar në një raport nga Petrovska, Mishevskaja, & Bogatinova (2019) përmes aktiviteteve mësimore, fëmija ka mundësi të mësojë rreth marrëdhënieve shkak-pasojë, me anë të së cilës fiton njohuri për kuptimin e termave të saktë ose të gabuar, mirë apo keq, në anën tjetër përmes aktiviteteve mësimore, fëmija gjithnjë e më shumë e njeh botën rreth saj.

Në këtë kapitull paraqesim metodologjinë e përdorur në hulumtim përfshirë metodat dhe qëllimin e hulumtimit, rëndësinë e hulumtimit, më pas prezantojmë instrumentet matëse, popullata, grumbullimi i të dhënave të hulumtimit, analiza e tyre si dhe pjesa e fundit përmban etikën dhe kufizimet e hulumtimit. Dizajni i këtij hulumtimi është mikse cilësore-sasiore, ana sasiore e këtij hulumtimi do të tregonë për nivelin e bashkëpunimit shkollë familje dhe aspektet cilësore të këtij studimi do të jenë ndikimet e bashkëpunimit shkollë-familje në performancën e nxënësve në mësim.

.1. Objektivat

Objektivi i përgjithshëm:

1: Ndikimi i bashkëpunimit shkollë-familje në zhvillimin e performaces së nxënësve në mësim

Objektiva të veçanta:

2: Të identifikohen format efikase të bashkëpunimit mësuese prind në aktivitete mësimore,

3: Studimi i metodologjive që përkrahin më së shumti rolin e bashkëpunimit mësues/e-prind.

.2. Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat

Pyetjet kërkimore:

Ky studim do të realizohet duke u bazuar në këto pyetje kërkimore:

1. Cili është niveli i bashkëpunimit shkollë familje komunitet dhe ndikimii tij në performancën e nxënësve
2. Cilat janë format më efektive të bashkëpunimit mesues/e-prind për realizimin e aktiviteteve mësimore?
3. Studimi i çasjeve metodologjike të bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet?

Hipotezat:

Hipoteza kryesore:

1. Mësueset, prindërit dhe komuniteti kanë bashkëpunim me njeri tjetrin dhe ky bashkëpunim ka ndikim të madhë në performancën e nxënësve.

Hipotezat ndihmëse:

2. Mësueset dhe prindërit mund të bashkëpunojnë në disa forma për realizimin e aktiviteteve mësimore si psh. gjatë mledhjeve me prindër, takime të posaçme individuale, gjatë aktiviteteve që u jepen për ti realizuar në shtëpi etj.
3. Ka çasje të ndryshme metodologjike që përkrahin bashkëpunimin shkolle-familje-komunitet.

.3. Parashtrimi i problemit

Bashkëpunimi mësuese-prind mbi realizimin e aktiviteteve mësimore në institucionet arsimore është definimi kryesorë i këtij hulumtimi, i cili ky bashkëpunim i inkurajon nxënësit në arritjen e qëllimeve të tyre gjatë gjithë jetes.

.4. Rëndësia e hulumtimit

Rëndësia e këtij hulumtimi qëndron në faktin se do të sjellë argumente dhe forma të bashkëpunimit mes mësueseve dhe prindërve në institucionet arsimore në Kosovë, për rëndësinë e bashkëpunimit, strategjitë dhe format e angazhimit të prindërve si dhe modelin shembull të punës së mësueseve në arritjen e qëllimeve të aktiviteteve mësimore përmes bashkëpunimit.

.5. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të matet dhe analizohet roli i bashkëpunimit mësuese-prind në realizimin e aktiviteteve mësimore të shkollës fillore. Të identifikohen strategjitë dhe format e bashkëpunimit dhe të analizohet efekti i këtyre strategjive dhe formave në aktivitetet mësimore tek fëmijët.

.6. Popullacioni dhe mostra

Popullacioni i këtij hulumtimi do të jenë të gjithë mësueset të ciklit fillorë nga klasa parafillore deri në klasën e pestë dhe prindër të caktuar në këshillin e prindërve. Për kornizë të mostrës do të shqyrtojmë raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (2019) e cila na tregon se në komunën e Ferizajit janë gjithësej 1.066 mësuese ndërsa në komunën e Gjilanit janë gjithësej 947 mësuese të ciklit fillorë. Perkatësisht në komunën e Ferizajit janë caktuar si moster rastësore 50 mësuese të nivelit fillorë dhe 45 prindër të nxënësve të këtyre shkollave ndërsa edhe në komunën e Gjilanit 46 mësuese po ashtu të këtij niveli dhe 34 prindër po ashtu të këtyre shkollave.

.7. Instrumentet matëse

Bazuar në pyetjet kërimore të hulumtimit të dhënat do të mbledhen përmes instrumentit matës si pyetësori. Pjesëmarrësit inkurajohen të përgjigjen përmes pyetjeve dhe udhëzimeve të dhëna në instrument. Natyra e pyetjeve synon të inkurajojë shfaqjen e koncepteve të reja. Kjo casje, lehtëson zhvillimin e një marrëdhënieje të besueshme midis pjesëmarrësve dhe studiuesit duke rritur kështu cilësinë e të dhënave të gjeneruara (Dearnley, 2005).

Pyetësori përmban trembëdhjetë pyetje, rënditja e të cilave do të sigurojë informacione që mbulojnë qëllimin e këtij hulumtimi, duke filluar nga qëllimet që ka roli i bashkëpunimit mësuese-prindër, format efektive të bashkëpunimit, ndikimin e këtij bashkëpunimi tek fëmijët.

1) Pyetësori

Pyetësori është i ndërtuar me shkallën e Likërit, me anë të këtij pyetësori do të grumbullohen një sërë informacionesh lidhur me rolin e bashkëpunimit mësuese- prind në realizimin e aktiviteteve mësimore në shkollat fillore.

.8. Etika e hulumtimit

Studimi ka parasysh standardet e etikës profesionale dhe respekton maksimalisht të dhënat dhe burimet e trajtuara më parë, gjithashtu ofron siguri dhe ruajtje të konfidencialitetit dhe mjedisit ku është kryer hulumtimi. Si parim kryesor ka përpjekjen për cilësi dhe përdorim më të mirë të burimeve, qasje të barabartë duke mos shfaqur anësi, dhe ka parasysh respektimin e autorësisë së individëve pjesëmarrës.

3.

REZULTATET E HULUMTIMIT

3.1. Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Procesi i mbledhjes së të dhënave ka zgjatur nga 03.02.2024 deri më 13.02.2024, për të katër institucione arsimore. Fillimisht janë njoftuar drejtorët e institucioneve arsimore për qëllimin e këtij studimi, dhe u është kërkuar leje për zhvillimin e hulumtimit, dhe pastaj është bërë realizimi i pyetësorit me mësuese dhe prindër të nxënësve të atyre institucioneve arsimore nga klasa parafillore deri në klasën e pestë.

3.2. Prezantimi i gjetjeve kryesore

Në këtë kapitull janë paraqitur rezultatet kryesore të studimit, të cilat ndërlidhen me qëllimin e këtij studimi. Prezantohen informacione mbi respondentët dhe më pas të dhënat në bazë të analizave të bëra.

Grafiku 1. Përqindja e numrit të mësueseve dhe prindërve në hulumtim sipas dy komunave

Në grafikun e parë janë paraqitur të dhënat, shprehur me përqindje për numrin e mësueseve dhe prindërve, të cilët janë përfshirë në hulumtim, të ndara në dy komuna siç shihet 50.53% (n=50) e mësueseve dhe 46.57% (n=45) e prindërve pjesëmarrës janë nga komuna e Ferizajit dhe 45.47% (n=46) e mësueseve dhe 34.43% (n=34) e prindërve pjesëmarrës janë nga komuna e Gjilanit.

Grafiku 2. Institucioni arsimor ku vijon fëmija mësimin, ofron mundësi që të marrë pjesë në realizimin e aktiviteteve mësimore

Bazuar në grafikun 2 kuptojmë që institucionet arsimore ku vijnë fëmijët në të dy komunat, ofron mundësi që të marrin pjesë në realizimin e aktiviteteve mësimore, nga 50 mësuese dhe 45 prindër të përfshirë në hulumtim nga komuna e Ferizajit 84% prej tyre i janë përgjigjur opsionit që pajtohen, dhe 46 % prej tyre pjesërisht pajtohem, 38% plotësisht pajtohem, 17% pjesërisht nuk pajtohen ndërsa aspak nuk pajtohen janë përgjigjur 15%. Ndërsa nga 46 mësuese dhe 34 prindër të përfshirë në hulumtim nga komuna e Gjilanit 98% prej tyre janë përgjigjur po ashtu opsionit pajtohem, 55% pjesërisht pajtohem, 31% plotësisht pajtohem, 13% pjesërisht nuk pajtohem dhe vetëm një përqindje e vogël më 8% aspak nuk pajtohem që institucioni arsimor ku vijon fëmija mësimin, ofron mundësi që të marrë pjesë në aktivitete mësimore.

Grafiku 3. Është përgjegjësi e prindit që të marrë pjesë në realizimin e aktiviteteve mësimore që zhvillohen në institucion arsimor ku fëmija ndjek mësimin

Gjetjet e hulumtimit tonë tregojnë që në komunën e Ferizajit një numër i madh i prindërve dhe mësueseve pajtohen që është përgjegjësi e prindit të marrë pjesë në realizimin e aktiviteteve mësimore të zhvilluara, 89% e mësueseve dhe prindërve pajtohen, 58% e tyre pjesërisht pajtohen, 29% e tyre plotësisht pajtohen 13% e tyre pjesërisht nuk pajtohen dhe një përqindje e vogël me 11% aspak nuk pajtohen. Po ashtu në komunën e Gjilanit mësueset dhe prindërit pajtohen me 78% që është përgjegjësi e prindërve të marrin pjesë në realizimin e aktiviteteve mësimore, 66% e tyre pjesërisht pajtohen, 33% plotësisht pajtohen, 14% pjesërisht nuk pajtohen dhe 13% aspak nuk pajtohen. Krahasuar nga dy komunat nuk shohim dallim të madh sa i përket përgjegjësisë që prindërit kanë për të marrë pjesë në realizimin e aktiviteteve mësimore.

Grafiku 4. Rregullisht njoftohemi për aktivitetet mësimore që zhvillohen në institucion arsimor

Rezultatet e hulumtimit duke u bazuar në grafikun e 4 tregojnë që prindërit janë të njoftuar rregullisht nga mësueset për zhvillimin e aktiviteteve mësimore në institucionet mësimore, ku në komunën e Ferizajit nga 50 mësuese dhe 45 prindër të anketuar shohim që 85% e tyre pajtohen, 62% pjesërisht pajtohen 42% plotësisht pajtohen dhe një përqindje mjaftë e vogël aspak nuk pajtohen. Ndërsa në komunën e Gjilanit nga 46 mësuese dhe 34 prindër të anketuar shohim që po ashtu edhe këtu prindërit janë të njoftuar për aktivitetet e realizuara ne institucion arsimor ku 68% e tyre pajtohen, 63% pjesërisht pajtohen, 57% plotësisht pajtohen dhe po ashtu një përqindje shumë e vogël me 12 % nuk pajtohen.

Grafiku 5. Ndajmë njohuritë dhe idetë e tona gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore që zhvillohen në institucion arsimor

Bazuar në grafikun e radhës përgjigjiet e mësueseve dhe prindërve nga të dy komunat se a i ndajnë njohuritë dhe idetë e tyre gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore në institucion arsimor, janë përgjigjur shumica prej tyre që po i ndajnë njohuritë së bashku ku 100% e prindërve dhe e mësuesve në komunën e Ferizajit janë përgjigjur me pajtohem, 39% pjesërisht pajtohem dhe 50% plotësisht pajtohem dhe aspak nuk pajtohem ka qenë një përqindje shume e vogel vetem 11% ndërsa sa i përket komunës së Gjilanit po ashtu ka pasur një përqindje të lartë më përgjigjien pajtohem 93%, pjesërisht pajtohem 19%, dhe plotësisht pajtohem 79% dhe pjesërisht nuk pajtohem 9%.

Grafiku 6. Prindërit janë të përfshirë në çdo mbledhje që organizon institucioni me interes për fëmijët e tyre

Duke u bazuar në grafikun e 6 shohim që prindërit janë të përfshirë në çdo mbledhje që organizon institucioni më interes për fëmijët e tyre, ku 60% e mësueseve dhe prindërve në komunën e Ferizajit pajtohen me këtë pyetje , 70% pjesërisht pajtohen, 24% plotësisht pajtohen, 26 përqind nuk pajtohen dhe 10% aspak nuk pajtohen. Ndërsa në komunën e Gjilanit 91% pajtohen 47% pjesërisht pajtohen, 37% pajtohen plotësisht një përqindje e vogël nuk pajtohen. Krahasuar nga të dy komunat shohim që komuna e Gjilanit ka një përqindje më të madhe sa i përket pjesëmarrjes së prindërve në takime apo mbledhje me 91% për dallim nga komuna e Ferizajit të cilët deklarojnë që me këtë pyetje pajtohen 60%.

Grafiku 7. Kontaktojmë vazhdimisht me institucion arsimor në mënyrë që të ndihmohet fëmija në shtëpi

Nga grafiku 7 nga deklaratat e prindërve dhe mësueseve mund të konstatojmë që në të dy komunat institucionet arsimore komunikojnë me prindërit në mënyrë që të dinë se sit ë ndihmojnë fëmijët në shtëpi. Në komunën e Ferizajit nga numri 50 i mësuesve dhe 45 i

prindërve vërejmë që 72% e tyre janë pajtuar, 51% plotësisht janë pajtuar, 44% pjesërisht janë pajtuar dhe 11% e prindërve të kësaj komune aspak nuk pajtohen. Në komunën e Gjilanit 79% janë deklaruar tek opsioni pajtohem 41% tek opsioni plotësisht pajtohem, 32% pjesërisht pajtohem dhe 36% pjesërisht nuk pajtohem dhe 12% aspak nuk pajtohem.

Grafiku 8. Mësuesja njofton për fushat kurrikulare ku fëmija ka nevojë për mbështetje

Referuar të dhënave nga grafiku 8 mund të konstatojmë se në të dy komunat mësueset i njoftojnë prindërit për fushat kurrikulare ku fëmija ka nevojë për mbështetje. Nga komuna e Ferizajit shohim që 60% e mësueseve dhe 56% e prindërve pajtohen me këtë opsion, 52% plotësisht pajtohen 21% pajtohen pjesërisht dhe vetëm 11% pjesërisht nuk pajtohen. Ndërsa në komunën e Gjilanit po ashtu 56% e mësueseve dhe 62% e prindërve pajtohen me këtë çështje, 37% e tyre plotësisht pajtohen, 36% pjesërisht pajtohen dhe vetëm 9% e të anketuarve nga kjo komunë pjesërisht nuk pajtohen.

Grafiku 9. Ne njoftohemi për aftësitë, nevojat, specifikat e tjera që mund të ndikojnë në procesin e edukimit dhe ta pajisë me udhëzime për formën e mbështetjes

Bazuar në të dhënat nga grafiku 9 mund të konstatojmë që mësueset dhe prindërit e anketuar nga komuna e Ferizajit me një përqindje mjaft të madhe 44% e mësueseve dhe 56% e prindërve pajtohen, 52% plotësisht pajtohen, 21% pjesërisht pajtohen, 12% pjesërisht nuk pajtohen dhe 8% aspak nuk pajtohen. Ndërsa nga komuna e Gjilanit 43% e mësueseve dhe 44% e prindërve po ashtu pajtohen me këtë deklaratë, 36% pjesërisht pajtohen, 52% plotësisht pajtohen, 15% pjesërisht nuk pajtohen dhe 10% aspak nuk pajtohen. Krahasuar të dy komunat nuk shohim ndonjë diferencë të madhe të dy komunat përqindjen më të madhe pajtohen.

Grafiku 10. Institucioni arsimor ofron hapësira ku mund të flasim për shqetësimet, nevojat, problemet dhe dëshirat lidhur me fëmijën.

Nga të dhënat në grafikun e 10 mund të konstatojmë që institucionet arsimore në të dy komunat nuk ofrojnë hapësira ku mund të flasin për shqetësimet, nevojat, problemet dhe dëshirat lidhur me fëmijën. Një përqindje me 58% e mësueseve dhe prindërve nga komuna e Ferizajit pajtohen plotësisht, 47% pajtohen pjesërisht, 42% pajtohen, 42% pjesërisht nuk pajtohen dhe 11% aspak nuk pajtohen. Po ashtu edhe në komunën e Gjilanit shohim që 43% mësueseve dhe 29% e prindërve pajtohen, 37% pjesërisht pajtohen, 40% plotësisht pajtohen 28% pjesërisht nuk pajtohen dhe 23% aspak nuk pajtohen. Sa i përket dallimeve midis dy komunave shohim që nuk ka shumë sepse në të dy komunat ka përqindje të dukshme që nuk pajtohen sa i përket kësaj çështje.

Grafiku 11. Metodatat që ju i përdorni i shihni efektive në përfshirjen e prindërve

Bazuar nga ky grafik mund të vërejmë që metodatat e përdorura nga mësueset kanë efekt në përfshirjen e prindërve, 50% e mësueseve dhe 56% e prindërve nga komuna e Ferizajit janë pajtuar, 61% pajtohen plotësisht, 33% pjesërisht pajtohen dhe me 0% janë përgjigjur që aspak dhe pjesërisht nuk pajtohen. Në komunën e Gjilanit po ashtu mund të vërejmë që 33% e mësuesve dhe 59% e prindërve pajtohen dhe 49% prej tyre pjesërisht pajtohen 59% plotësisht pajtohen dhe po ashtu 0% janë përgjigjur që aspak dhe pjesërisht nuk pajtohen.

Grafiku 12. Format e komunikimit që ju i përdorni për të komunikuar, ndikojnë tek realizimi i aktiviteteve mësimore

Sipas grafikut 12 nga deklaratat e prindërve dhe të mësueseve në të dy komunat mund të konstatojmë që format e komunikimit që përdorin mësueset dhe prindërit në mes tyre ndikojnë në realizimin e aktiviteteve mësimore. Në komunën e Ferizajit 60% e mësueseve dhe 78% e prindërve janë deklaruar se pajtohen , 62% e tyre pajtohen plotësisht ndërsa opsionet e tjera kanë qenë me 0%. Po ashtu edhe në komunën e Gjilanit 57% e mësuseve dhe 41% e prindërve janë pajtuar, 45% pjesërisht janë pajtuar dhe 57% janë pajtuar plotësisht.

Grafiku 13. Fëmijët angazhohen me aktivitete mësimore në shtëpi dhe prindërit i përgjigjen këtij angazhimi

Referuar të dhenave nga grafiku 13 konstatojmë se fëmijët angazhohen me aktivitete mësimore në shtëpi dhe prindërit i përgjigjen këtij angazhimi. Nga komuna e Ferizajit shohim se 60% mësuesve dhe 67% e prindërve janë pajtuar, 47% janë pajtuar plotësisht 10% nga mësueset pjesërisht nuk janë pajtuar dhe po ashtu 10% pjesërisht nuk janë pajtuar. Ndërsa në komunën e Gjilanit 43% e mësueseve dhe 59% janë pajtuar dhe 36% janë pajtuar plotësisht, 23% pjesërisht pajtohen, 15% e mësuseve dhe 3% e prindërve aspak nuk pajtohen dhe 9% mësuesev dhe 12% e prindërve pjesërisht nuk pajtohen.

Në këtë kapitull janë paraqitur gjetjet kryesore të hulumtimit. Organizimi i gjetjeve kryesore të hulumtimit është bërë në ndërlidhje me analizën e literaturës së huaj dhe vendore, hulumtimet e ngjashme me këtë fushë, duke arritur që të marrim përgjigje për pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura të këtij hulumtimi.

Hulumtimi kishte për qëllim kryesor: *“Analizimin e rolit të bashkëpunimit mes mësuesve dhe prindërve në organizimin e aktiviteteve mësimore në shkollën fillore”*.

Për të përmbushur qëllimin e hulumtimit u përdor metoda sasiore dhe cilësore për mbledhjen e të dhënave. Ndërsa rezultatet që janë marrë përmes pyetësorit për mësues/e-prindër, do të diskutohen në këtë kapitull.

4.1. Diskutimi mbi shpërndarjen demografike të respondentëve-prindërve

Ky hulumtim është realizuar me një mostër prej $N=96$ mësuese të shkollave fillore dhe 79 prindër, të cilët fëmijët e tyre vijojnë mësimin në ato shkolla fillore. Hulumtimi u realizua në dy komuna të Kosovës. Nga komuna e Ferizajt janë të përfshirë në hulumtim 50.53% e mësueseve dhe 45.47% e prindërve , ndërsa nga komuna e Gjilanit 46. 57 % e mësueseve dhe 34.43% e prindërve.

4.2. Diskutimi mbi rolin dhe format e bashkëpunimit mësues/e-prind në realizimin e aktiviteteve mësimore

Të dhënat mbi rezultatet e hulumtimit treguan se në institucionet tona arsimore përdorin forma të bashkëpunimit gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore në mes mësueseve dhe prindërve dhe ky bashkëpunim ka një rol të rëndësishëm tek fëmijët . Bazuar në Ligjin mbi Edukimin arsimor Nr. 02/ L-52 (2006) prindërit gëzojnë të drejtën e bashkëpunimit gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore në institucionet arsimore. Për të parë se a iu ofrohet kjo mundësi prindërve në institucionet tona arsimore , të dhënat nga hulumtimi treguan se rreth 84% e mësuesve dhe të prindërve nga komuna e Ferizajt janë përgjigjur që iu ofrohet mundësia për të marrë pjesë në realizimet e aktiviteteve mësimore dhe vetëm 17% kanë deklaruar se nuk iu ofrohet mundësi të marrin pjesë në realizimin e aktiviteteve mësimore po ashtu edhe nga deklartat e mësueseve dhe prindërve të komunës së Gjilanit shohim që 98% janë përgjigjur se iu ofrohet mundësia dhe vetem një përqindje shumë e vogël janë përgjigjur që nuk iu ofrohet mundësia. Duke u bazuar në të gjeturat e hulumtimit tonë, kuptojmë se prindërve iu ofrohet mundësi e mjaftueshme për të bashkëpunuar me mësueset gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore . Sa i përket çështjes se a është përgjegjësi e prindërve të marrin pjesë në realizimin e aktiviteteve

mësimore , sipas deklaratave të prindërve dhe mësueseve nga të dy komunat shihet se me një përqindje rreth 89% nga komuna e Ferizajit dhe 78% nga komuna e Gjilanit pajtohen se kanë përgjegjësi të marrin pjesë në realizimin e aktiviteteve mësimore dhe vetëm 11% e prindërve dhe mësuesve nga komuna e Ferizajit dhe 13% nga komuna e Gjilanit nuk pajtohen me këtë çështje . Sipas MASHT (2014) personeli siguron informacionin e nevojshëm dhe të vazhdueshëm në lidhje me veprimtarinë e institucionit arsimor, në mënyrë të qartë, të gjeturat e hulumtimit tonë, janë në përputhje me atë që MASHT rekomandon, ku prindërit dhe mësueset e komunës së Ferizajit pajtohen 85% dhe mësueset dhe prindërit e komunës së Gjilanit pajtohen me 68% që institucionet arsimore njoftojnë për aktivitetet mësimore që realizohen me fëmijët e tyre, ndërsa 12% e prindërve dhe mësueseve pjesëmarrëse nuk pajtohen sa i përket kësaj çështje. Sahin, Inal, Ozbey (2011) në hulumtimin e tyre treguan që bashkëpunimi i mësueseve dhe prindërve ka një rol kryesor në realizimin e aktiviteteve mësimore dhe që fëmijët gjatë pjesëmarrjes së prindërve në aktivitete nuk e konsiderojnë institucionin të izoluar nga prindërit dhe fitojnë vetëbesim, po ashtu ata janë të kënaqur edhe emocionalisht. Sipas rezultateve të studimit shihet që numër më i madh i prindërve dhe mësueseve pjesëmarrëse nga të dy komunat pajtohen me këtë çështje 80%, ndërsa nuk pajtohen 19% prindër dhe mësuese pjesëmarrëse se ndajnë njohuritë dhe idetë e tyre gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore ky bashkëpunim ndikon në performancën e fëmijëve po ashtu Sipas Shehu, et al., (2014) mësueset duhet të hulumtojnë se cilat janë dituritë dhe nevojat e prindërve në lidhje me fëmijët dhe në bazë të tyre të zhvillojnë plane për aktivitete mësimore pra, mësueset dhe prindërit bashkërisht të marrin vendime se si të nxitet procesi i të nxënies tek fëmijët. Po ashtu Hulumtimi i realizuar nga Tahsini, Duci & Voko (2014) tregon se është e rëndësishme që prindërit të jenë të përfshirë në çdo mbledhje që organizon institucioni me interes për fëmijët e tyre ,e në hulumtimin tonë këtë më së miri e dëshmojnë vetë pohimet e mësueseve dhe prindërve të anketuar të cilët tregojnë se afro 60% e mësueseve dhe prindërve në komunën e Ferizajit pajtohen dhe 90% po ashtu mësuese dhe prindër në komunën e Gjilanit pajtohen ndërsa 26% e prindërve dhe mësuesve te Ferizajit dhe 15% mësuese dhe prindër të Gjilanit nuk pajtohen. Për sa i përket partneritetit efikas ndërmjet institucionit arsimor sipas Kurrikulës Bërthamë të arsimit fillorë (2014) pjesëmarrja e prindërve i referohet involvimit të prindërve në aranzhimet e bëra nga institucionet arsimore për të ndihmuar dhe kontribuar prindërit në efektivitetin e vendimeve në arsimimin e fëmijëve të tyre, aktivitetet të cilat mbështesin plan programin e atyre të cilat asistojnë në veprimin e institucioneve arsimore. Nga deklaratat e mësueseve dhe prindërve të anketuar shohim që kanë kontakt vazhdimisht mësueset dhe prindërit në mënyrë që te

ndihmohen fëmijët e tyre edhe në shtëpi nga të dy komunat shihet që komunikojnë mes tyre të cilët 72% e mësuesev dhe prindërve në komunën e Ferizajit dhe 79% e prindërve dhe mësueseve të komunës së Gjilanit janë pajtuar dhe vetëm 11% e prindërve dhe mësueseve të komunës së Ferizajit dhe 12% e prindërve dhe mësueseve nga komuna e Gjilanit nuk janë pajtuar. Sipas Federatës Amerikane të Mësimdhënësve (2007) kontakti dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm në mes të mësueseve dhe prindërve u sjell dobi të dyja palëve, duke marrë ide nga njëri-tjetri se si të ndihmojnë dhe mbështesin fëmijët e tyre. Sipas pohimeve të mësueseve dhe prindërve nga të dy komunat shohim se një përqindje prej 60% e mësueseve dhe prindërve të komunës së Ferizajit dhe 56 % e mësueseve e 62 % e prindërve të komunës së Gjilanit njoftohen për fushat kurrikulare ku fëmija ka nevojë për mbështetje dhe vetëm një përqindje e vogël nga komuna e Ferizajit me 11% dhe me 9% në komunën e Gjilanit nuk pajtohen. Duke u bazuar në studimin e Selimi (2012) një ndër veçoritë më të rëndësishme të një bashkëpunimi të frytshëm të prindërve me mësuesen e fëmijës është kur komunikimi mes tyre nuk kufizohet ose nuk reduktohet në informata dhe situata të rastit dhe sipërfaqësore për fëmijën, por zhvillohet në mënyrë partneriteti dhe është transparent dhe se ky komunikim ka ndikim të madh në performancën e fëmijës. Sipas përgjigjeve të nxjerra nga prindërit dhe mësueset shohim që 56% e mësueseve dhe prindërve nga komuna e Ferizajit pajtohen se njoftohen për aftësitë, nevojat, specifikat e tjera që mund të ndikojnë në procesin e edukimit dhe arsimimit po ashtu edhe në komunën e Gjilanit 44% e prindërve dhe mësueseve pajtohen dhe vetëm një përqindje e vogël nga të dy komunat nuk pajtohet. Referuar grafikut 10 mund të konstatojmë se 58% e mësueseve dhe prindërve në komunën e Ferizajit pajtohen se insiticioni arsimor ofron hapsira ku mund të diskutojnë rreth ecurisë së fëmijës dhe në komunën e Gjilanit 43% e mësueseve dhe 29% e prindërve pajtohen me këtë çështje dhe 11% e prindërve dhe mësueseve të Ferizajit dhe 23% e mësueseve dhe prindërve të Gjilanit nuk pajtohen aspak nga kjo arrijmë të konstatojmë që institucionet arsimore ofrojnë hapsira ku prindërit dhe mësueset mund të diskutojnë.

Duke u bazuar në studimet e Vadahi (2002) thekson që institucionet arsimore duhet të krijojnë një dhomë të posaçme për prindërit ku pjesëtarët e familjes mund të takohen me mësueset, të lexojnë informacion për fëmijët e institucionit dhe fëmijën e tyre në veçanti për çështje të tilla si shëndeti, disiplina, aktivitetet mësimore ose tema të tjera që ju interesojnë. Po ashtu bazuar në grafikun 11. arrijmë në përfundim që metodat që mësueset përdorin janë shumë efektive për përfshirjen e prindërve ku 50% e mësueseve dhe 56% e prindërve nga komuna e Ferizajit dhe 33% e mësueseve dhe 59% e prindërve të komunës së Gjilanit janë pajtuar më këtë çështje dhe në deklaratat e tjera nuk ka pasur fare

përqindje nga kjo mund të vërehet që metodat e ndryshme që përdorin mësueset dhe prindërit janë efektive në proceset mësimore. Format e komunikimit që i përdorin për të komunikuar ndikojnë në realizimin e aktiviteteve mësimore edhe këtu kemi një përqindje të lartë të prindërve dhe mësuesve të cilët kanë deklaruar se janë pajtuar ku 60% e prindërve dhe mësueseve kanë deklaruar se pajtohen dhe po ashtu 57% e prindërve dhe mësuesve në komunën e Gjilanit po ashtu pajtohen dhe 0% kanë qenë opsionet tjera. Sa i përket angazhimit në aktivitete mësimore në shtëpi dhe se a ju përgjigjen prindërit këtij angazhimi vërehet po ashtu që prindërit dhe mësuesit nga komuna e Ferizajit 60% janë pajtuar dhe 10% pjesërisht nuk janë pajtuar ndërsa në komunën e Gjilanit 59% e mësueseve dhe prindërve janë pajtuar dhe 12% pjesërisht nuk pajtohen dhe nga këto përqindje vërehet që prindërit i përgjigjen angazhimit të aktiviteteve mësimore në shtëpi.

5.

Përfundime dhe rekomandime

Në këtë kapitull do të paraqiten përfundimet dhe rekomandimet për secilën hipotezë të ngritur të këtij hulumtimi. Bazuar në rezultatet e hulumtimit dhe interpretimin e tyre janë paraqitur përfundimet, pas paraqitjes së përfundimeve janë dhënë edhe rekomandimet që janë të ndara në varësi të nivelit që i drejtohen, duke filluar nga Drejtoritë Komunale të Arsimit, institucionet arsimore, mësues/e deri tek prindërit.

6.1. Përfundime të përgjithshme

Ky hulumtim kishte për qëllim që të analizohet roli i bashkëpunimit të mësueseve me prindërit gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore . Studimi është realizuar duke përdorur metodën miks të hulumtimit. Ai u realizua në 2 komuna të Kosovës, më gjerësisht në komunën e Ferizajt dhe në komunën e Gjilanit, ku përmes pyetësorit morën pjesë 94

mësues/e dhe 79 prindër, fëmijët e të cilëve vijonin edukimin në shkollat fillore nga klasa parafillore deri në klasën e pestë.

H1. Mësueset, prindërit dhe komuniteti kanë bashkëpunim me njëri tjetrin dhe ky bashkëpunim ka ndikim të madhë në performancën e nxënësve.

Nga rezultatet e hulumtimit dhe të diskutimeve mund të vërtetojmë hipotezën e parë të hulumtimit, që mësueset dhe prindërit kanë bashkëpunim me njëri tjetrin dhe ky bashkëpunim ndikon në performancën e fëmijëve. Sipas deklaratave të mësueseve dhe prindërve të anketuar vërejmë që ka forma të ndryshme të bashkëpunimit si forma kryesore të bashkëpunimit për realizimin e aktiviteteve mësimore janë bashkëbisedimet që zhvillojnë për të marrë pjesë prindërit në aktivitete mësimore , angazhimi në realizimin e aktiviteteve kur fëmijët kanë nevojë për ndihmë edhe në shtëpi dhe po ashtu këto forma ndikojnë tek realizimi i aktiviteteve dhe tek fëmijët pra në performancën e tyre.

H2. Mësueset dhe prindërit mund të bashkëpunojnë në disa forma për realizimin e aktiviteteve mësimore si psh. gjatë mbledhjeve me prindër, takime të posaçme individuale, gjatë aktiviteteve që u jepen për ti realizuar në shtëpi etj.

Nga analiza e të dhënave sasiore dhe cilësore, të paraqitura në kapitullin e katërt dhe diskutimi i tyre në kapitullin e pestë mund të konkludojmë se hipoteza e hulumtimit tonë është vërtetuar. Nëpërmjet të dhënave në pyetësorë shumica e prindërve dhe mësueseve deklaruan se komunikimi i tyre dhe i prindërve ndikon në përfshirjen e prindërve në aktiviteteve mësimore , ku kanë pohuar që gjatë bashkëbisedimeve me prindër zakonisht flasin rreth arritjeve që fëmijët tregojnë kur përfshihen edhe prindërit në aktivitete mësimore të realizuara në institucion arsimor. Dhe kjo ndikon që përfshirja e prindërve në aktivitete të jetë më e lartë. Po ashtu shihet që komunikimi mes mësueseve dhe prindërve ndikon në përfshirjen gjatë zhvillimeve të aktiviteteve mësimore dhe se përdorin forma të ndryshme si mbledhje me prindër, takime individuale për të komunikuar për shqetësimet, nevojat problemet dhe dëshirat e fëmijëve, po ashtu angazhohen edhe në shtëpi me fëmijët më aktivitetet mësimore .

H3.Ka çasje të ndryshme metodologjike që përkrahin bashkëpunimin shkolle-familje-komunitet.

Nga shqyrëtimi i literaturës dhe gjetjeve mund të vërtetojmë se hipoteza e tretë e studimit është vërtetuar, ku nga të dhënat e cekura te pedagogëve dhe psikologëve të ndryshëm vërejmë që ka çasje të ndryshme metodologjike duke filluar nga metodologjia e “Reggio Emilias”, metodologjia “Hap pas Hapi”, metodologjia “Montessori” etj.

Si konkluzion, mund të themi se gjetjet e hulumtimit, të interpretuara dhe diskutuara më lart, mbështesin hipotezat e hulumtimit dhe janë në përputhje me gjetjet e hulumtimeve të tjera.

6.2. Rekomandime

Në bazë të analizës së temës, janë nxjerrë këto rekomandime:

Rekomandime për DKA:

- Të ndërmarrin fushata sensibilizuese për prindërit me qëllim vetëdijesimi për rëndësinë e përfshirjes së tyre gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore në institucione arsimore .

Rekomandime për institucionet arsimore :

- Të marrin për bazë Ligjin mbi Edukimin arsimor, për bashkëpunimin mësues/e-prind gjatë realizimeve të aktiviteteve mësimore.
- Të nxisin bashkëpunimin e mësuesesëve me prindërit gjatë realizimeve të aktiviteteve mësimore.

Rekomandime për mësues/e:

- Të jenë të përgatitur për bashkëpunim me prindërit gjatë realizimeve të aktiviteteve mësimore.
- Të nxisin bashkëpunim me prindër gjatë aktiviteteve mësimore dhe ndonjëherë ta bëjnë edhe hapin e parë.

- Të përdorin forma të ndryshme të bashkëpunimit në varësi të nevojave të prindërve.
- Duke krijuar një bashkëpunim të mirë mësues/e-prindër gjatë realizimit të aktiviteteve mësimore do të krijohet një klimë më e mirë në klasë dhe puna e tyre do të jetë më e lehtë, fëmijët do ta konsiderojnë këtë bashkëpunim si mbështetje kryesore të tyre.
- Të zhvillohen kampanja për vetëdijesimin e prindërve që të marrin pjesë në aktivitete mësimore.

Rekomandime për prindërit:

- Të marrin pjesë vullnetarisht në zhvillimin e aktiviteteve mësimore, duke ndarë kohë për fëmijën e tyre dhe fëmijët e tjerë, të institucionit arsimor.
- Të jenë më aktivë gjatë realizimeve të mësimore edukative që zhvillohen në institucione arsimore.
- Të jenë më këmbëngulës në të drejtën e tyre për pjesëmarrje në aktivitetet mësimore që zhvillohen në institucione arsimore.
- Të shohin më të rëndësishme pjesëmarrjen e tyre gjatë mbledhjeve dhe takimeve që institucioni arsimor iu ofron.

Referencat

- AFT. (2007). Building Parent- Teacher Relationships. *Classroom Tips*, 3-6.
- Bicaj, A., Bytyqi, A., Azizi, T., & Xhemajli, A. (2018). Cooperation of preschool institutions with parents toward early childhood education. *THESIS*, 7(2), 82-83.
- Bierman, K., Morris, P., & Abenavoli, R. (2017). Parent Engagement Practices Improve for Preschool Children. *ISSUE BRIEF*, 2-7.
- Boeree, G. (2004). *Teoritë e personalitetit*. Tiranë: Plejad.
- Bongiorno , L. (2018). Talking with Parents about Play and Learning. *Teaching Young Children*, 11(05).
- Bronfenbrenner, U. (1979). *The Ecology of Human Development Experiments By Nature And Design*. Cambridge, Massachusetts, and London England: Haward University Press.
- Coughlin, P. A., Hansen, K. A., Heller, D., Kaufmann, R. K., Stolberg, J. R., & Walsh, K. B. (1997). *Creating Child- Centered Classrooms: 3-5 Olds. Step By Step: A Program for Children and Families*. Uashington, DC: Organizata botërore e Burimeve për fëmijë.
- Dearnley, C. (2005). A Reflection on the Use of Semi-Structured Interviews. *Nurse*, 13(1), 19-28.
- Demaio, D. (2018). Family involvement in Montessori Preschool. *Kingsley Montessori School*.
- Dolya, G. (2010). *Vygotsky in Action in the Early Years*. New York: Taylor & Francis - Library.
- Epstein, A. (2015). Montessori Early Childhood Teacher Perceptions of family Priorities and Stressors. *Journal of Montessori Research*, 1(1), 2-3.
- Epstein, J. L. (2011). *School, Family and Community Partnerships, Preparing Educators and Improving Schools*. United State of America: Westview Press.
- Henry, K. S., & Friesen, A. (2018, August/September). Promoting powerful Interaction Between Parents and Children. *Teaching Young Children*, 11(05).

- Hill, N. E., & Craft, S. A. (2003). Parent-School Involvement and School Performance: Mediated Pathways Among Socioeconomically Comparable African American and Euro-American Families. *Journal of Educational Psychology, 95*(1), 74-83.
- Hill, N. E., & Taylor, L. (2004). Parental School Involvement and Children's Academic. *Current Directions in Psychological Science, 13*.
- Hoover-Dempsey, K. V., & Sandler, H. M. (1997). Why Do Parents Become Involved in Their Children's Education? *Review of Educational Research, 67*(1), 3-42.
- Hornby, G. (2011). *Parental Involvement in Childhood Education Building Effective School-Family Partnerships*. New York: Springer.
- Hughes, J., & Kwok, O.-m. (2007, February). Influence of Student-Teacher and Parent-Teacher Relationships on Lower Achieving Readers' Engagement and Achievement in the Primary Grades. *Journal of Educational Psychology, 99*(1), 39-51.
- Ingram, M., Wolfe, R. B., & Lieberman, J. M. (2007). The Role of Parents in High-Achieving Schools Serving Low- Income, At-Risk Popolar. *Education and Urban Society, 39*(4), 479-497.
- Jean.M,Lilian.K, Anne.R, Dianne.R. (2003). Coonecting with parents in Early Years. New York: University of Illinois at Urbana-Champaign.
- Kolucki, B., & Lemish, D. (2011). *Communicating with Children Principles and Practices to Nurture Inspire, Exite, Educate and Heal*. New York: Unicef.
- Kulinxha, G. (2015). *Komunikimi ndërpersonal në fëmijërinë e hershme sipas programit me fëmijën në qendër*. Prishtinë: Libri shkollor.
- Kurtulmus, Z. (2016). Analyzing parental involvement dimensions in early childhood education. *academicJournals, 11*, 1150.
- Larocque, M., Kleiman, I., & Darling, S. M. (2011). The missing Link in School Achievement. *Preventing School Failure, 55*(3), 115-122.
- Lee, J.-S., & Bowen, N. (2006). Parent Involvement, Cultural Capital, and the Achievement Gap among Elementary School Children. *American Educational Research Association, 43*(2), 193-218.
- Lopez, G. (2001). The Value of Hard Work: Lessons on Parent Involvement from an (Im)migrant Household. *Havard Educational Review, 71*(3), 416-438.

- MASHT. (2006). *Mbi edukimin arsimor*. Retrieved Januar 22, 2024, from Mbi edukimin arsimor: http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L52_al.pdf
- MASHT. (2014). *Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor*. Retrieved 2024, from Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/standardet-parashkollore.pdf>
- MASHT. (2016). *Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (klasat 0,I, II, III, IV,V)*. Prishtinë: Cip.
- MASHT. (2019). *Statistikat e arsimit ne Kosove*. Prishtine.
- Mato, E., & Kamani, P. (2000). *Në kërkim të njohjes*. Tiranë: " Marin Barleti".
- McDowell, K., Jack, A., & Copmton, M. (2018, 01 07). Parent Involvement in Pre-Kindergarten and the Effects on Student Achievement. *The Advocate*, 23(6), 6-7.
- Newsom, S., & Vincent, L. (2015). Character Development Goals for Preschool Children. *Childhood Education*, 250-253.
- Petrovska, N., Mishevskaja, S. P., & Bogatinova, T. (2019). *Prind i drejt, fëmija i drejt: doracak për prindërsi positive*. Shkup: UNICEF.
- Rahman, S., Chowdhury, K. Q., & Obaydullah, A. (2019). Perception of Parents of Their Involvement in Children's Learning Activities in Preschool. *ResearchGate*, 5, 1863-1873.
- Sahin, F. T., Inal, G., & Ozbey, S. (2011). Parent Involvement activities from parents' point of view. *International Journal of Academic Research*, 3(6), 421.
- Selimi, N. (2012). *Bazat e integritetit arsimor*. Retrieved Januar 21, 2024, from Instituti Zvicerian i studimeve shqipëtare: <http://www.iseal.ch/wp-content/uploads/2013/03/Parashkollor.pdf>
- Shehu, F., Pallçevska, S., Niçova, A., Zindl, V., Mladenovik, B., Ançevska, B., & Janeva, N. (2014). *Zbatimi i standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm*. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale: Shkup.
- Tahsini, I., Duci, V., & Voko, K. (2014). *Roli i institucioneve dhe i mësuesve për të krijuar partneritet në mbështetje të prindërve në zhvillimin tërësor të fëmijëve*. Tiranë: Save the Children.

Tahsini, I., Duci, V., & Voko, K. (2014). *Roli i institucioneve dhe i mësuesve për të krijuar partneritet në mbështetje të prindërve në zhvillimin tërësor të fëmijëve*. Tiranë: Save the Children.

Vadahi, F. (2002). *Pedagogjia Parashkollore*. Shkodër: "Camaj-Pipa".

Walker, J. T., Wilkins, A., Dallaire, J., Sandler, H., & Hoveer- Dempsey, K. (2005, November). Parental Involvement: Model Revision through Scale Development. *The Elementary School Journal*, 106(2), 85-104.

Walls, J. K. (2018). To What Extent Do Parents of Montessori-Educated Children " Do Montessori" at Home? Preliminary Findings and Future Directions. *Journal of Montessori Research*, 4(1), 15-16.

Woolfolk, A. (2010). *Educational Psychology (Eleventh edition ed.)*. PEARSON.

Wortham, S. C. (2013). *Common Characteristics and Unique Qualities in Preschool Programs*. New York: Springer.

Zuna, A. D. (2003). *Edukimi i parashkollorit në familje*. Prishtinë: DinOr & M.G.

Zuna, A. D., & Bashkëautorët. (2009). *Partneriteti Shkollë-Familje-Komunitet*. Prishtinë: Libri shkollor.

Shtojcë

Pyetësori

Të nderuar kolegë-e dhe prindër, qëllimi i këtij studimi është “Roli i bashkëpunimit mësues/e-prind në realizimin e aktiviteteve mësimore në shkollën fillore”. Njëherit ky qëllim paraqet edhe temën time të diplomës në nivelin Master. Të gjitha të dhënat e mbledhura do të shfrytëzohen vetëm për qëllimin e këtij studimi dhe do të jenë plotësisht konfidenciale.

Pyetësori është plotësisht anonim, andaj ju lutemi që të jeni sa më të sinqertë, dhe mendimet e juaja t’i shprehni lirshëm.

<p><i>ut lutemi ndosni shprehni mendimet tuaja (✓) për njërin nga opsionet e të mëposhtme</i></p>	<p>Aspak nuk pajtohem</p>	<p>Pjesërisht nuk pajtohem</p>	<p>Pajtohem</p>	<p>Pjesërisht pajtohem</p>	<p>Plotësisht pajtohem</p>
<p>institucioni simor ku jon fëmija nesimin, ofron undësi që të arrë pjesë në realizimin e aktiviteteve esimore</p>					
<p>shtë përgjegjësi e indit që të arrë pjesë në realizimin e aktiviteteve esimore që shprehin në institucion simor ku mija ndjek esimin</p>					
<p>regullisht</p>					

oftohemi për
aktivitetet
ësimore që
villohen në
stitucion
simor

dajmë
ohuritë dhe
etë e tona
atë
alizimeve të
aktiviteve
esimore në
stitucion
simor

rindërit janë të
ërfshirë në çdo
bledhje që
ganizon
stitucioni me
teres për
mijët e tyre

ontaktojmë
zhdimisht me
stitucion
simorë në
ënyrë që të
lihmohet

mija në
itëpi

lësuesja
ijofton për
ishat
irrikulare ku
mija ka
levojë për
bështetje

e njoftohemi
r aftësitë,
evojat,
ecifikat e
era që mund
ndikojnë në
rocesin e
lukimit, dhe ta
ajisë me
lhëzime për
rmën e
bështetjes

stitucioni
simor ofron
pësira ku
und të flasim
r shqetësimet,
evojat,
oblemet dhe

<p>ëshirat lidhur e fëmijën</p>					
<p>letodat që ju ërdorni i vishni efektive ë përfshirjen e vëndërve</p>					
<p>format e komunikimit që ju përdorni për të komunikuar, shikojnë tek analizimi i aktiviteteve të mësimore</p>					
<p>shprehjet të përdorura në aktivitetet të mësimore në klasë, dhe vëllimet i të përdorura këtu në mësimin të mësimin</p>					